



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 216/2013**

**7 mars 2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJL nr. 1 datë 19.6.2013	Akuzuar për veprën penale të dezertimit, parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak.....	9379
Vendim i GJL nr. 4, datë 10.12.2013	Me objekt: - Anulimin e vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 i K.K.Pronave Dibër. - Anulimin e kontratës së shitjes nënshkruar midis AKP-së, dega Dibër dhe të paditurit Ibrahim Lika me nr. 60, datë 31.8.2001. - Detyrimi i palës së paditur të na njohë pronar mbi një sipërfaqe toke, të ndodhur në fshatin Urakë, prej 9 ha.....	9388

**VENDIM**  
**Nr. 1 datë 19.6.2013**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Ardian Dvorani	kryesues
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Guxim Zenelaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Andi Çeliku	anëtar
Medi Bici	anëtar
Edmond Islamaj	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Artan Broci	anëtar
Tom Ndreca	anëtar,

asistuar nga sekretare gjyqësore Elona Kardhiqi, në datën 18.6.2013 dhe 19.6.2013 morën në shqyrtim në çështjen penale me nr. 5/4 Akti, regj. themeltar, me palë:

**KËRKUES:** Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjyq nga prokurori pranë Gjykatës së Lartë, Arqilea Koça.

**I GJYKUAR:** Stilian Vathi, i biri i Fadilit dhe i Ëngjëllushes, i datëlindjes 2.12.1983, banues në Rr. "Myslym Shyri", pallati 6, shk. 1, përfaqësuar nga Avokati Koli Bele, i caktuar kryesisht.

**AKUZUAR:** Për veprën penale të dezertimit, parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 111, datë 13.3.2007,** ka vendosur:

*"-Deklarimin fajtor të të pandehurit Stilian Fadil Vathi për kryerjen e veprës penale të dezertimit parashikuar nga neni 33/1 i K.P.Ushtarak dhe dënimit e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim. - Vuajtja e dënimit fillon nga dita e ekzekutimit të këtij vendimi."*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 948 akti, datë 24.5.2007,** ka vendosur:

*"- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.*

*- Rivendosjen në afat të ankimit të kërkuarit Stilian Vathi kundër vendimit gjyqësor nr. 111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

**Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 24, datë 13. 9.2007,** ka vendosur:

*"- Lënien në fuqi të vendimit nr. 111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë."*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1569, datë 9.11.2007,** ka vendosur:

*"- Pranimin e kërkesës.*

*- Rivendosjen në afat të ankimit për në Gjykatën e Lartë kundra vendimeve gjyqësore nr. 111, datë*

*13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. 24, datë 13.9.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë."*

**Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs i gjykuari Stilian Vathi,** nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtuar këto shkaqe:

*"- Të dy vendimet e gjykatave janë marrë në mungesë të të pandehurit, pa u njoftuar ai për datën dhe orën e gjykimit, duke i mohuar atij në këtë mënyrë të drejtën për një proces të rregullt e të drejtë gjyqësor, duke shkelur rëndë dispozitat procedurale penale që garantojnë një proces të rregullt ligjor.*

*- Në gjykimin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë mungojnë njoftimet e rregullta për të pandehurin prandaj dhe me të drejtë po kjo gjykatë ka pranuar kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.*

*- Të njëjtin gabim ka bërë edhe gjykata e apelit, ku edhe pse dihej adresa e saktë e të pandehurit, nuk ekziston asnjë fletëhirrje që t'i jetë komunikuar atij apo ndonjë familjari të tij, për më tepër që nga kjo gjykatë nuk është njoftuar as avokati i caktuar me prokurë nga i pandehuri, duke zhvilluar edhe ajo një proces jo të rregullt ligjor.*

*- Në Gjykatën e Apelit Tiranë është bërë njoftimi me shpallje për të pandehurin në kundërshtim me kërkesat e nenit 140/4 të K.P.Penale, pasi nuk janë respektuar asnjë prej kërkesave të kësaj dispozite.*

*- Gjykatat kanë gabuar edhe në kualifikimin ligjor të veprës penale, pasi nuk jemi para elementeve të veprës penale të parashikuar nga neni 33/1 i Kodit Penal Ushtarak, sepse i pandehuri është larguar nga reparti me leje për shkak se e ka pasur nënën shumë të sëmurë dhe është proceduar dhe arrestuar pa u vënë në dijeni për këtë procedim."*

**Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. s'ka, datë 21.10.2009,** ka vendosur:

*"Kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim njehsimin e praktikës gjyqësore."*

**Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendim nr. 5/4 regjistri themeltar, datë 20.1.2011,** kanë vendosur:

*"Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr. 5/4 regj. themeltar datë 11.1.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e dispozitave të pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42, pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës."*

**Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, me vendim nr. 31, datë 17.5.2012,** ka vendosur:

“- *Pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të KPP-së, për shprehjen “në gjykatën e apelit”.*

- *Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të KPP-së.”*

## **KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË**

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Mirela Fana dhe Medi Bici; mendimin e prokurorit Arqilea Koça, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Ushtarak Tiranë; në mungesë të përfaqësuesit të të pandehurit; pasi e bisedoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **VËREJNË:**

#### **I. Rrethanat e faktit**

1. Nga shqyrtimi gjyqësor në dyja shkallët e gjykimit dhe vendimet e dhëna nga të dyja gjykatat e faktit, rezultojnë të pranura prej tyre rrethanat si vijon: i pandehuri Stilian Vathi është mobilizuar nga Dega e Mobilizimit Ushtarak Tiranë me datë 8.8.2006 për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe është caktuar në repartin ushtarak “Qendra Stërvitore Vertop” në Berat, ku edhe ka kryer periudhën stërvitore të karantinës.

2. Pas përfundimit të karantinës më datë 4.10.2006, i pandehuri Stilian Vathi është transferuar në repartin ushtarak nr. 4451 Tiranë, për të kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak aktiv.

3. Më datën 6.12.2006, i pandehuri Stilian Vathi është larguar pa leje nga reparti nr. 4451 Tiranë, largim për të cilën komanda e këtij reparti ushtarak ka bërë kallëzim penal pranë Prokurorisë Tiranë.

4. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedimin penal me nr. 395, në datën 20.12.2006, në ngarkim të të pandehurit Stilian Vathi, akuzuar për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar nga neni 33/1 të K.P.Ushtarak.

5. Hetimet paraprake në ngarkim të tij, si dhe gjykimi i çështjes janë bërë në mungesë të të pandehurit.

#### **II. Procedurat gjyqësore**

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 111, datë 13.3.2007, ka deklaruar fajtor të gjykuarin Stilian Vathi për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë i Kodit Penal Ushtarak, vepër për të cilën është dënuar me 6 muaj burgim.

7. Më datë 11.5.2007, Policia Gjyqësore e komisarariatit të policisë nr. 2 Tiranë ka bërë ekzekutimin e vendimit nr. 111, datë 13.3.2007 ndaj të gjykuarit Stilian Vathi.

8. I gjykuari Stilian Vathi, meqenëse kishte humbur afatin për të bërë ankim në gjykatën e apelit, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me 9380

kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit.

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 948 akti të datës 24.5.2007, ka pranuar kërkesën e të gjykuarit Stilian Vathi për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit të themelit nr. 111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

10. Mbi ankimin e të gjykuarit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 24, datë 13.9.2007, ka lënë në fuqi vendimin nr. 111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin i gjykuari Stilian Vathi është deklaruar fajtor për veprën penale të “Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë, i Kodit Penal Ushtarak, duke u dënuar me 6 muaj burgim.

11. Përveç sa më sipër, i gjykuari Vathi, ka paraqitur kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për t’u rivendosur në afat e drejta e tij për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 24, datë 13.9.2007, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i fajësisë dhe dënimit të tij.

12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1569 akti, datë 9.11.2007, ka pranuar kërkesën e të gjykuarit për t’u rivendosur në afat e drejta e tij për të paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

13. Në bazë të këtij vendimi, i gjykuari Stilian Vathi ka paraqitur rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet avokatit të tij, i cili ka kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rigjykim, duke parashtruar shkaqet e përmendura në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

14. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë prokurori Artur Selmani ka pretenduar se rekursi i të gjykuarit nuk duhet të merret në shqyrtim, pasi vendimi që ka rivendosur në afat të drejtën e rekursit për të gjykuarin është i pabazuar në ligj dhe konkretisht, përcaktimeve të nenit 147 të K.P.Penale, në pjesën që ka të bëjë me marrjen dijani efektivisht për vendimin e ankimit.

15. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim këtë çështje në seancën gjyqësore të datës 21.10.2009, ka konstatuar se zgjidhja e kësaj çështjeje ka lidhje me interpretimin dhe zbatimin e nenit 147 të K.P.Penale, parë në aspekt të respektimit të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ-së. Gjithashtu, Kolegji ka konstatuar qëndrime jo të njëjta si nga gjykatat me të ulëta, ashtu edhe nga vetë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji Penal, si rrjedhojë e këtyre qëndrime të ndryshme, në bazë të nenit 438 të K.P.Penale dhe me qëllimin e ndryshimit dhe njësim të praktikës gjyqësore, me vendimin nr. 1641/833 regjistri të datës 21.10.2009, ka vendosur të kalojë çështjen penale, që i përket të dënuarit Stilian Vathi, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

17. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendim nr. 5/4, regjistri themeltar, datë 20.1.2011, kanë vendosur *“Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr. 5/4 Regj. Themeltar datë 11.1.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e dispozitave të pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42 pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës”*.

18. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë me vendim nr. 31, datë 17. 5.2012, ka vendosur: *“-Pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të KPP-së, për shprehjen “në gjykatën e apelit”. Rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të KPP-së”*.

### III. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

19. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se, nga gjykatat më të ulëta, por edhe nga vetë Kolegji Penal i kësaj gjykate, mbahen qëndrime të ndryshme në lidhje me kuptimin e institutit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, qëndrime të ndryshme në interpretimin dhe zbatimin e nenit 147 të KPP-së.

20. Duke iu referuar praktikës unifikuese të saj vlerëson të sjellë në vëmendje përfundimet unifikuese të shprehura në vendimin nr. 2 të vitit 2002, në të cilin kolegjet janë investuar dhe janë shprehur posaçërisht për institutin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit.

21. Kështu, Kolegjet e Bashkuara me vendimin unifikues të vitit 2002 kanë ardhur në përfundimin se gjykata (kompetente) që duhet të procedojë me shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në çdo rast e rrethanë, është gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se *“...në kuptim të nenit 147 të KPP-së, kërkesa për rivendosje në afat për të bërë ankim paraqitet (shqyrtohet) në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe si e tillë duhet kuptuar përgjithësisht gjykata e shkallës së parë (gjykata e rrethit gjyqësor përkatës). Kjo rezulton nga përmbajtja e pikave 5 dhe 6 të nenit 147 të KPP-së. ... pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në themel ose jo edhe nga gjykata e apelit, kompetente për të shqyrtuar kërkesën për rivendosjen e afatit të ankimit është gjykata e shkallës së parë. Gjykata e apelit dhe pas saj Gjykata e Lartë shqyrtojnë vetëm ankimet kundër vendimeve respektive...”*.

22. Por, pavarësisht sa më lart, Kolegjet konstatojnë se, si nga gjykatat më të ulëta, edhe nga vetë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vazhdohet të mbahen qëndrime jo të njëjta në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e institutit të rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit. Dhe konkretisht, konstatohen qëndrime jo të njëjta në lidhje me kuptimin e termave të përdorur në këtë dispozitë, si:

“gjykatë kompetente” për të shqyrtuar kërkesën për rivendosje në afat të ankimit, “organ që procedon”, palët që duhet të marrin pjesë në shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, e drejta e ankimit në rastet e pranimit apo refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat etj.

23. Kolegji Penal, si rrjedhojë e këtyre qëndrime të ndryshme, në bazë të nenit 438 të K.P.Penale dhe me qëllimin e ndryshimit dhe njësimin të praktikës gjyqësore, me vendimin nr. 1641/833, regjistri të datës 21.10.2009, ka vendosur të kalojë çështjen penale, që i përket të dënuarit Stilian Vathi, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke shtruar për diskutim këto çështje për unifikim:

23. i) *Kundër vendimit të gjykatës, që lejon rivendosjen në afat për bërjen e rekursit, a mund të bëhet ankim nga palët përpara shqyrtimit të çështjes së themelit në Gjykatën e Lartë dhe cili do të konsiderohet “vendim përfundimtar”, sipas kuptimit të nenit 147/5 të K.P.Penale?*

23. ii) *Nëse Gjykata e Lartë, gjatë shqyrtimit të rekursit, konstaton se vendimi i rivendosjes në afat vjen ndesh me ligjin, a ka të drejtë të ndërhyjë në këtë vendim nëse nuk ka rekurs nga palët ndaj vendimit të themelit, nisur nga pengesa e ligjit për ankimin ndaj vendimit që lejon rivendosjen në afat?*

23. iii) *Nëse në gjykimin e çështjes në gjykatën e apelit njëra nga palët kërkon mospranimin e ankimit me arsyetimin se vendimi që ka pranuar kërkesën për rivendosjen në afat është në kundërshtim me ligjin, a ka të drejtë gjykata e apelit të shqyrtojë këtë kërkesë pa i hyrë shqyrtimit gjyqësor të themelit, nisur nga përmbajtja e nenit 147/5 të K.P.Penale, sipas të cilit vendimi që lejon rivendosjen në afat mund të ankimohet vetëm me vendimin përfundimtar”?*

24. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi kanë marrë në shqyrtim këtë çështje në seancën gjyqësore të datës 20.1.2011, me vendimin nr. 5/4 regjistri themeltar, kanë vendosur: *“Pezullimin e gjykimit të çështjes penale me nr. 5/4 regj. themeltar datë 11.1.2010 dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar pajtueshmërinë e pikave 4 dhe 6 të nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale me nenet 3, 4, 42 pika 2, 43 dhe 135 të Kushtetutës”, me arsyetimin se formulimi i nenit 147 të Kodit të Procedurës Penale në pikat 4 dhe 6 nuk janë në pajtim me Kushtetutën dhe veçanërisht me nenet 3, 4, 42, pika 2, 43 dhe 135 të saj.*

25. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në shqyrtimin e kërkesës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 6 të nenit 147 të KPP-së, për shprehjen “në gjykatën e apelit” dhe rrëzimin e kërkesës për shfuqizimin e pikës 4 të nenit 147 të KPP-së.

26. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj arsyeton se: "... Sipas pikës 6 të nenit 147 të KPP-së. ankimi kundër vendimit të refuzimit të kërkesës mund të bëhet në gjykatën e apelit". Shprehja "në gjykatën e apelit" të çon në përfundimin se mospranimi është vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Si rrjedhim, gjykata vlerëson se kuptimi/zbatimi jo i drejtë i dispozitës së nenit 147/4 rrjedh pikërisht nga togfjalëshi "në gjykatën e apelit" i parashikuar në nenin 147/6 të KPP-së. Nëse pjesë e këtij togfjalëshi nuk do të ishte "e apelit", atëherë ankimi do të bëhej në gjykatën më të lartë respektive ndaj vendimit të dhënë nga një gjykatë më e ulët, kompetenca e së cilës do të përcaktohej sipas rastit. Në këtë mënyrë, do të garantohej edhe parimi i gjykatës së caktuar me ligj, parashikuar nga neni 42/2 i Kushtetutës. Për këtë arsye, gjykata çmon se togfjalëshi "në gjykatën e apelit" bie ndesh me nenin 42/2 dhe 135 të Kushtetutës...".

27. Në lidhje me çështjet që shtrohen për unifikim për efekt të njësimin të praktikës gjyqësore, tashmë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, në seancën gjyqësore të datës 18.6.2013 përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme mbajti qëndrimin se: "unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me kompetencën e gjykimin të kërkesave për rivendosje në afat, ku kompetente e gjykimin të kërkesës për rivendosje në afat t'i takojë asaj gjykate e cila është kompetente për shqyrtimin e atij mjeti ankimi që kërkohet të rivendoset në afat. Unifikimin e praktikës në rastin kur gjykata kompetente refuzon kërkesën për rivendosje në afat, atëherë, në rast refuzimi të rivendosjes në afat të apelit, ndaj atij vendimi të mund të ushtrohet rekurs ose në rast të refuzimit të rivendosjes në afat të rekursit, vendimi të konsiderohet përfundimtar. Unifikimin e praktikës në rastin kur gjykata kompetente pranon kërkesën për rivendosje në afat, atëherë në rast të pranimit të kërkesës për rivendosje në afat të apelit ndaj atij vendimi të mund të ushtrohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Në rast të pranimit të rivendosjes në afat të rekursit vendimi të konsiderohet përfundimtar".

28. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të shkaqeve të parashtruara në rekursin e të gjykuarit për zbatim të gabuar të ligjit penal procedural nga ana e gjykatave të faktit, vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh kuptimi e zbatimi i dispozitave të Kodit Procedurës Penal lidhur me institutin procedural të rivendosjes në afat, të parashikuara në dispozitat në titullin III, kreu III të K.P.Penale, të titulluar "AFATET".

29. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të theksojnë se

ligjvënësi, me qëllimin e mbrojtjes si të interesave të të pandehurve (së drejtës subjektive), ashtu edhe të interesit të shoqërisë në një proces gjyqësor penal, ka përcaktuar në mënyrë të qartë në ligjin procedural penal afate procedurale për të hartuar aktet procedurale, të detyrueshme për t'u zbatuar si për gjykatat, ashtu edhe nga palët ndërgjyqëse në një proces penal.

30. Rivendosja në afat është një institut procedural që përlligj karakterin formal të ligjit procedural. Ligjvënësi ka përcaktuar se rivendosja në afat, që nënkupton kthim mbrapa në kohën procedurale, pra kthim në momentin kur ka lindur e drejta për të përbushur aktin procedural, është një institut përjashtimor, i mirëpërcaktuar dhe jo i mundshëm për t'u zbatuar për çdo lloj rasti.

31. Instituti i rivendosjes në afat ka si qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konkretisht garantimi i ushtrimit të së drejtës nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim në një gjykatë më të lartë, në ato raste, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi, kur nuk ka pasur mundësi që ta ushtrojë këtë të drejtë brenda afatit ligjor.

32. Rivendosja në afat lejon palën ndërgjyqëse të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të themelit, pavarësisht tejkalimit të afateve, të cilat për shkak të natyrës prekluzive, me plotësimin apo kalimin e tyre, kanë çuar në dekadencë të së drejtës së saj për të ushtruar këtë ankim.

33. Siç është përmendur më sipër në pjesën përshkruese-arsyetuese të këtij vendimi, ligjvënësi ka parashikuar institutin e rivendosjes në afat në titullin III, kreu III të K.P.Penale, e konkretisht:

1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore.

2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit.

4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj.

5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.

6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për

*rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit” (neni 147 i K.P.Penale).*

34. Rastet e parashikuara nga neni 147 i K.P.Penale për rivendosjen në afat duhen interpretuar në mënyrë shteruese, të lidhura ngushtësisht me arsyet objektive që kanë penguar palën në ushtrimin efektiv të së drejtës së saj. Kështu pika 1 e nenit 147 parashikon “*forcën madhore*” apo “*rastin fator*”, si shkak për t’u rivendosur në afat të ankimit kundër një vendimi penal themeli.

35. Ndërsa pika 2 e nenit 147 përcakton si shkak për rivendosjen në afat, “*gjykimin në mungesë*” për aq sa provohet se, i pandehuri nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e procesit dhe vendimin.

36. Rastet e sipërcituara përbëjnë kusht “*sine qua non*”, ekzistenca e të cilave justifikon në mënyrë të mjaftueshme paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat. Pala që është ndodhur në këto kushte ka të drejtë që t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për rivendosje në afat. Me anë të kësaj kërkesë, pala që është ndodhur në kushtet e pamundësisë objektive të paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të themelit, synon që të rifitojë përsëri kohën që ka kaluar që nga momenti i verifikimit të shkakut deri në momentin e zhdukjes së tij.

37. Shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ekzistencës së kushteve dhe provave të nevojshme për vërtetimin e tyre bëhet nga gjykata gjatë zhvillimit të një procesi, i cili nuk është i njëjtë me gjykimin e themelit të çështjes, bazuar edhe në premisat logjike dhe funksionale që e karakterizojnë atë, ku kërkuksi ka detyrimin (barrën) për të provuar situatën në të cilën është ndodhur, e cila pa fajin e tij e ka vendosur në pamundësi absolute për të respektuar afatet procedurale. Pra, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ligjvënësi ka normuar të drejtën e kërkuksit për t’u rivendosur në afat, por vetëm nëse ai provon se nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe vendimit, të provojë se kjo padijeni nuk ka ardhur për faj të tij.

38. Në vijim të këtij arsytimi dhe nga shqyrtimi i dispozitave të sipërcituara, Kolegjet e Bashkuara evidentojnë se dispozitat që kanë sjellë debate, qëndrime të ndryshme dhe vështirësi në praktikën gjyqësore janë ato të pikës 4, 5 dhe 6 të nenit 147 të këtij Kodi, ku parashikohet se: “*4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. 5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar. 6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit*”.

39. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke pasur parasysh edhe qëndrimet përkatëse në

vendimin nr. 31, datë 17.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese, arrijnë në përfundimin se është vendi për të ndryshuar qëndrimet e tyre të mëparshme, ndryshe nga praktika e unifikuar aktualisht e vendosur sipas vendimit unifikues nr. 2, datë 14.10.2002, në lidhje me mjetin procedural të rivendosjes në afat të ankimit, pra edhe dispozitat e neneve 147 e 148 të KPP-së.

40. Në rrethanat kur dispozitat e ligjit procedural nuk parashikojnë rregulla më të hollësishme, nuk janë të qarta apo përmbajnë edhe ndonjë kundërshti mes tyre, janë gjykatat ato që duhet të zgjidhin çështjen duke i zbatuar normat juridike në përputhje me qëllimin e përmbajtjen e tyre dhe në respektim të parimeve themeltare mbi të cilat qëndron procedimi penal në një shtet të së drejtës.

41. Në vijim të arsytimit të mësipërm, në referim të çështjeve që janë shtruar për unifikim, Kolegjet e vlerësojnë me vend t’iu japin përgjigje këtyre pyetjeve:

i) *Cila do të konsiderohet gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat, gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankim, apo gjykata që do të shqyrtojë ankimin për vendimin e themelit?*

ii) *Në procesin e shqyrtimit të ankimit, cilat do të jenë palët pjesëmarrëse në proces?*

iii) *Në varësi të pranimit apo të rrëzimit të kërkesës për rivendosje në afat, cila do të jetë gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit dhe a lejohet që palët në të dy rastet të bëjnë ankim (pra si kur rrëzohet, ashtu edhe kur pranohet kërkesa për rivendosje në afat).*

42. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjigje të pyetjeve të sipërcituara do të kenë në konsideratë, ndër të tjera, edhe vlerësimet dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.

43. Konkretisht në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se: “... gjykata vlerëson se paqartësia që pretendohet nga gjykata referuese se, shprehja “organi që procedon” nënkupton patjetër gjykatën e shkallës së parë, nuk rrjedh nga pika 4 e nenit 147 të K.P.Penale, por nga kuptimi që i është dhënë kësaj shprehje nga vetë gjykata referuese në vendimin unifikues të saj. Shprehja “organi që procedon” i referohet organit që ka dhenë vendimin, ndaj të cilit kërkon të ankohet i gjykuari. Pra, nëse i gjykuari kërkon të ushtrojë ankim ndaj vendimit të apelit, kërkesën për rivendosje në afat duhet ta shqyrtojë gjykata e apelit dhe jo gjykata e rrethit gjyqësor ...”

*A. Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së parë*

44. Duke pasur parasysh sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në përgjigje të pyetjes së parë të shtruar për zgjidhje (*Cila do të konsiderohet gjykatë kompetente për shqyrtimin e kërkesës për*

*rivendosjen në afat, gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit është ushtruar ankim, apo gjykata që do të shqyrtojë ankimin për vendimin e themelit?*), arrin në qëndrimin unifikues se: **Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata që ka dhënë vendimin ndaj të cilit ushtrohet ankim. E thënë ndryshe, nëse kërkohet rivendosje në afat për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jetë gjykata e shkallës së parë. Respektivisht, nëse kërkohet rivendosja në afat për të bërë ankim (rekurs) kundër vendimit të gjykatës së apelit, kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat është gjykata e apelit.**

45. Në këtë përfundim Kolegjet vlerësojnë se janë në koherencë të plotë me konkluzionet e Gjykatës Kushtetuese të shprehura në vendimin nr. 31, datë 17.5.2012.

*B. Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së dytë*

46. Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së dytë të shtruar për unifikim (*Në procesin e shqyrtimit të ankimit cilat do të jenë palët pjesëmarrëse në proces?*), Kolegjet e Bashkuara do të nisen nga përcaktimi i bërë nga ligjvënësi në nenin 147, pika 1 e K.P.Penale, i cili përcakton se: "...prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore...".

47. Në vështrim të këtij përcaktimi të ligjvënësit, duke e parë dispozitën e nenit 147 të K.P.Penale në tërësi, në harmoni me dispozitat e tjera të këtij kodi, që përcaktojnë përgjithësisht formën e procesit gjyqësor penal dhe palët pjesëmarrëse në këtë proces, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se palët pjesëmarrëse në procesin gjyqësor për rivendosje në afat, do të jenë pikërisht ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 147 të K.P.Penale.

**48. Në vijim të arsytimit të mësipërm Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në qëndrimin unifikues se: palë pjesëmarrëse në gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat do të jenë sipas rastit: prokurori, i pandehuri (i gjykuari), palët private dhe mbrojtësit përkatës.**

*C. Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së tretë*

49. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për unifikim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë me vend trajtimin e saj në dy situata të ndryshme, ashtu siç i parashikon ligjvënësi në nenin 147 të K.P.Penale, e konkretisht:

- *e para*: në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat pranohet nga gjykata, pra kur pala që ka humbur afatin është rivendosur në afat për të bërë ankim;

- *e dyta*: në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata.

50. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë më të ndërlikuar në dukje situatën e parë të pyetjes së tretë të shtruar për zgjidhje e pikërisht kur kërkesa për rivendosje në afat pranohet nga gjykata, pra kur pala që ka humbur afatin është rivendosur në afat për të bërë ankim, situatë ligjore e parashikuar nga ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.P.Penale: "5. *Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar...*".

51. Pra, ndryshe nga parashikimi i pikës 6 të nenit 147, sipas të cilit pala kërkuese mund të bënte ankim menjëherë dhe në çdo rast kur kërkesa për rivendosje në afat refuzohet nga gjykata, në rastin e parashikuar në pikën 5 të po këtij neni, ligjvënësi ka vendosur kufizime për palën që kërkon të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës që lejon rivendosjen në afat.

52. Sipas këtij parashikimi, pala e cila nuk është dakord me vendimin e gjykatës që ka rivendosur në afat të drejtën për të bërë ankim, jo në çdo rast mund të ankohet kundër këtij vendimi, por vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.

53. Për efekt të kuptimit dhe zbatimit të drejtë të ligjit, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë me vend të sqarojmë edhe njëherë kuptimin e vendimit përfundimtar të gjykatës, të cituar nga ligjvënësi.

54. Gjykata (e cilësdo shkallë gjykimi), shprehet me tre lloje vendimesh: 1. Me vendim të ndërmjetëm. 2. Me vendim jo përfundimtar; dhe 3. Me vendim përfundimtar.

55. Vendime të ndërmjetme janë ato që jepen gjatë gjykimit për të siguruar zhvillimin e gjykimit në mënyrë të rregullt në pajtim me kërkesat e dispozitave procedurale, si p.sh. vendimi për pranimin ose refuzimin e kërkesës për marrjen e një prove, për shtyrjen e gjykimit, për kryerjen e një ekspertimi etj.

56. Vendimet jopërfundimtare janë të gjitha llojet e vendimeve që pa e zgjidhur çështjen në themel i japin fund procesit gjyqësor penal të filluar.

57. Ndërsa vendime përfundimtare janë ato vendime që zgjidhin çështjen në themel, ku përfshihen jo vetëm vendimet e gjykatës së apelit, por edhe vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor që zgjidhin në themel çështjen (p.sh. që deklarojnë fajtor të pandehurin, që e deklarojnë të pafajshëm atë etj.).

58. Në këtë kuadër, në interpretim të pikës 5 të nenit 147 të K.P.Penale, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në qëndrimin unifikues se pala (pjesëmarrëse në gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat), e cila nuk është dakord me vendimin për rivendosjen në afat, nuk mund të bëjë ankim në çdo kohë kundër këtij vendimi. Ajo (pala) mund të ankohet kundër

vendimit të rivendosjes në afat, vetëm nëse ankohet për vendimin përfundimtar të gjykatës, që do të thotë kundër vendimit që ka zgjidhur çështjen në themel dhe vetëm bashkë me këtë vendim.

59. Pra, nëse kërkesën për rivendosje në afat e ka shqyrtuar gjykata e rrethit gjyqësor (dhe ka vendosur pranimin e saj), pala që nuk është dakord me këtë vendim mund të bëjë ankim ndaj tij vetëm nëse ankohet kundër vendimit të gjykatës së apelit që ka zgjidhur çështjen në themel në këtë rast (mbi bazën e ankimit të paraqitur bashkë me vendimin për rivendosje në afat), sepse ai është vendimi përfundimtar për të cilin shprehet ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.P.Penale.

60. Në analizë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëndrimi i mbajtur nga ligjvënësi në këtë rast është plotësisht i drejtë, pasi nëse pala e cila nuk ka qenë dakord me vendimin për rivendosjen në afat, por është dakord dhe nuk ka ankim kundër vendimit përfundimtar që ka zgjidhur çështjen në themel, nuk do të bënte sens që kjo palë të ankohej vetëm kundër vendimit për rivendosjen në afat. Në këtë rast mjeti i ankimit do të ishte jo efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së.

61. Por, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se situata duket e pazgjidhur plotësisht për rastin tjetër, kur kërkesën për rivendosje në afat e ka gjykuar gjykata e apelit. Në këtë rast vendimi përfundimtar, për të cilin bën fjalë ligjvënësi në pikën 5 të nenit 147 të K.P.Penale, është vendimi i Gjykatës së Lartë dhe palët nuk mund të ankohen kundër këtij vendimi.

62. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga qëllimi përfundimtar i gjykimit, që është dhënia e drejtësisë dhe zgjidhja në themel e çështjes, çmojnë se, pavarësisht se pala nuk mund të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të rivendosjen në afat e vendosur nga gjykata e apelit, kjo nuk përbën një shkelje të së drejtës për një mjet efektiv ankimi, pasi ky vendim mund të shihet si vendim i ndërmjetëm, si një vendim që jepet gjatë gjykimit për të siguruar zhvillimin e gjykimit në mënyrë të rregullt në pajtim me kërkesat e dispozitave procedurale.

63. Gjithsesi Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se ky është një qëndrim i ligjvënësit dhe siç është shprehur qartë Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 31, datë 17.5.2012 “... I takon ligjvënësit të parashikojë një mjet ankimi efektiv lidhur me këtë fazë për të garantuar të drejtën kushtetuese të ankimit të garantuar nga neni 43 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së...”.

64. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë më të thjeshtë në dukje situatën e dytë, pra kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata, është parashikuar nga ligjvënësi në pikën 6 të

nenit 147 të K.P.Penale e konkretisht: “...kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit”.

65. Në vështrim të këtij parashikimi të ligjvënësit, duke qenë se ai (ligjvënësi) kishte parashikuar mundësinë e ankimit në gjykatën e apelit, kuptohet qartë se gjykata kompetente për gjykimin e kërkesës për rivendosje në afat, në çdo rast, është gjykata e shkallës së parë që ka dhënë vendimin e themelit të çështjes.

66. Në këtë këndvështrim, përfundimi i arritur nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin unifikues nr. 2 të vitit 2002 se: “...në kuptim të nenit 147 të K.P.Penale, kërkesa për rivendosje në afat për të bërë ankim bëhet në gjykatën që ka dhënë vendimin dhe si e tillë duhet kuptuar përgjithësisht gjykata e shkallës së parë...”, ka qenë i drejtë në raport me interpretimin korrekt të dispozitës.

67. Në kushtet kur situata ligjore ka ndryshuar pas vendimit nr. 31, datë 17.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese me riformulimin e pikës 6 të nenit 147 të K.P.Penale: “6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim”, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë edhe njëherë se nuk mund të jetë Gjykata e Lartë gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat për të drejtën e ankimit, pasi kundër vendimit të Gjykatës së Lartë nuk mund të bëhet ankim.

68. Në vijim të sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në qëndrimin unifikues se: në rastin kur kërkesa për rivendosje në afat është refuzuar nga gjykata e rrethit gjyqësor, kundër këtij vendimi, pala kërkuese (prokurori, i pandehuri, palët private apo mbrojtësit) mund të bëjë ankim në gjykatën e apelit. Gjithashtu, edhe në rastin kur kërkesa refuzohet nga gjykata e apelit, pala kërkuese mund të bëjë ankimin (rekursin) në Gjykatën e Lartë.

#### IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

69. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit dhe jurisprudencën jo vetëm të Gjykatës së Lartë, por edhe të Gjykatës Kushtetuese e GJEDNJ-së, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga i gjykuari Stilian Vathi gjenden të bazuara në ligj për sa i përket njoftimit të tij nga gjykata e apelit ushtarak, duke shkelur në këtë mënyrë kriteret e vendosura nga nenet 132 - 141 dhe 351 të KPP-së.

70. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi nr. 24, datë 13.9.2007 i Gjykatës e Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 111, datë 13.3.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e të cilit i gjykuari Stilian Vathi është deklaruar fajtor për veprën penale të



“Dezertimit”, parashikuar në nenin 33, paragrafi i parë i Kodit Penal Ushtarak, duke u dënuar me 6 muaj burgim, është i pambështetur në ligjin penal procedural dhe për rrjedhim duhet të priset dhe aktet duhet të kthehen për rishqyrtim në po atë gjykatë.

71. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezultojnë se Gjykata e Apelit Tiranë ka zhvilluar gjykimin në mungesë të të gjykuarit duke mos e njoftuar atë, në kundërshtim me kriteret ligjore të parashikuara në nenet 132 - 141 të K.P.Penale.

72. Gjykata e apelit rezultojnë se për zhvillimin e seancës gjyqësore të datës 5.7.2007 ka njoftuar të gjykuarin me anë të fletëthirrjes që mban datën 11.6.2007, duke e dërguar në adresën: rruga “Myslym Shyri”, pall. 6, shk. I, Tiranë.

72.1 Kjo gjykatë në seancën gjyqësore të datës 5.7.2007, në bazë të nenit 140/4 të KPP-së, ka vendosur njoftimin e të gjykuarit me shpallje, pasi fletëthirrja e lartpërmendur është kthyer nga Posta Shqiptare me shënimin se “nuk njihet në këtë adresë”. Këtë njoftim gjykata ka urdhëruar të vendoset përsëri në adresën e të gjykuarit: rruga “Myslym Shyri”, pall. 6, shk. I, Tiranë dhe në njësinë bashkiake nr. 7, Tiranë.

73. Rezultojnë, gjithashtu, se në seancën e datës 5.7.2007, në bazë të njoftimit me shpallje të lartpërmendur, gjykata e apelit ka vendosur zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit dhe ka caktuar kryesisht avokat Luan Muho.

74. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se gjykata e apelit ka zbatuar gabim ligjin procedural penal lidhur me njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij. Kolegjet konstatojnë se i gjykuari Stilian Vathi nuk është njoftuar për orën dhe datën e caktuar nga gjykata për zhvillimin e gjykimit sipas kërkesave procedurale penale; njoftimi i tij është bërë me shpallje në kundërshtim me ligjin, duke i mohuar atij të drejtën për të marrë pjesë në gjykim, të mbrohet vetë apo me anë të mbrojtësit, të realizojë të gjitha kërkesat kushtetuese e ligjore të një procesi të rregullt ligjor.

75. Kolegjet vlerësojnë se njoftimi me shpallje i datës 5.7.2007 nuk i plotëson kriteret e nenit 140 të KPP-së. Ky njoftim nuk është vendosur në banesën e saktë ku banon i pandehuri. Rrjedhimisht edhe vendimi i gjykatës për zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit, caktimin e një avokati mbrojtës kryesisht dhe vazhdimi i gjykimit në praninë e tij (avokatit), nuk është i mbështetur në ligjin procedural penal. Rezultojnë se së bashku me ankimin e depozituar në gjykatë, i pandehuri Stilian Vathi kishte depozituar prokurën e posaçme datë 18.5.2007, nr. 403 rep., nr. 108 Kol., me anë të së cilës kishte caktuar përfaqësuesin e tij av. Ismail Qesja.

76. Kolegjet e Bashkuara, në referim të kriterëve që përcakton Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Kodi i Procedurës Penale, çmojnë se njoftimet e bëra nga gjykata për pjesëmarrjen e të gjykuarit në gjykim nuk mund të pranohen si realizim i së drejtës së mbrojtjes së tij, në procesin penal, pasi bien në kundërshtim me:

76.1 Neni 6 i Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut, në të cilin parashikohet se: *“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuzë penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalojë shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.*

*2. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

*a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;*

*b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*

*c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*

*d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;*

*e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq..”*

76.2 Neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: *“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë: a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij; b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;...ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirish dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme; ...”*

76.3 Neni 6 i Kodit të Procedurës Penale në të cilin

parashikohet se: “1. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit. Kur nuk ka mjete të mjaftueshme i sigurohet mbrojtja falas me avokat. 2. Mbrojtësi ndihmon të pandehurin që t’i garantohen të drejtat procedurale dhe t’i ruhen interesat e tij ligjore”.

77. Kolegjet theksojnë se akti gjyqësor i njoftimit të personit kundër të cilit është hapur një proces penal është i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat e ligjit procedural, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të së drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar “in absentia”, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t’u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë 2000*).

78. Standardet lidhur me njoftimin dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të të gjykuarit janë vendosur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke çmuar se heqja dorë nga ushtrimi i së drejtës së garantuar nga Konventa duhet të përcaktohet saktësisht. “Kur ligjet kombëtare lejojnë realizimin e gjykimeve në mungesë për një person “të akuzuar penalisht”, menjëherë, sapo ai merr dijeni për këtë proces, duhet të ketë të drejtën për t’u dëgjuar nga gjykata mbi pretendimet e akuzës. Autoritetet kombëtare kanë një marzh vlerësimi për zgjedhjen e mjeteve në sistemet e tyre ligjore, por me kusht që këto mjete juridike të jenë në përputhje me standardet e vendosura nga neni 6/1 i Konventës” (*Colozza kundër Italisë, 1985*).

79. Në zhvillim të jurisprudencës së saj lidhur me zhvillimin e procesin “in absentia” Gjykata Evropiane ka theksuar se: “... e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë.” (*Ektabani kundër Suedisë 1988 Vaundelle kundër Francës 2003*); se: “Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte”. (*T and V kundër Mbretërisë së Bashkuar*); se: “Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t’i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij”. (*Poitrimol kundër Francës 1993, Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë 2001*); se: “Është e një rëndësie thelbësore që i akuzuari duhet të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t’i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t’i

krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustificueshme (*Geysseghem kundër Belgjikës 1999*); se: “Informimi i një personi mbi procedimin penal të filluar ndaj tij është një akt ligjor me një rëndësi të tillë që duhet të zbatohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mirëfillta të afta për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtave të akuzuarit”. (*Zyflli kundër Shqipërisë 2005*); se: “Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t’u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq”. (*Mariani kundër Francës, 2005*).

80. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në garantimin e së drejtës themelore për një proces të rregull ligjor vlerësojnë të theksojnë dhe rezolutën (75) 11 “Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit” të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në të cilën rekomandohen standardet minimale për shtetet anëtarë mbi njoftimin e të gjykuarit dhe zhvillimin e procesin në mungesë të tij, të tilla si: i) Askush nuk duhet të gjykohej pa pasur një thirrje për gjyq në kohë. ii) Kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim. iii) Kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit... vi) Një vendim gjykate i dhënë në mungesë duhet t’i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë. vii) Çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t’i jepet e drejta për apelim me çdo lloj mjeti ligjor, që do t’i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm. viii) Për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t’i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit. ix) Një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij”.

81. Në mbështetje sa më sipër, Gjykata Kushtetuese ka konsoliduar praktikën lidhur me interpretimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi njoftimin e të pandehurit dhe zhvillimin e gjykimit në mungesë të tij.

82. Kjo gjykatë ka theksuar se: “... Dispozitat procedurale për njoftimet vendosin një rend të caktuar

*për mënyrën e njoftimit të akteve për të pandehurin, prandaj duhet respektuar rendi sipas preferencës ligjore për këtë qëllim. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigorozë të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë kur janë respektuar në mënyrë rigorozë dispozitat për njoftimin....Në radhë të parë është e domosdoshme që i pandehuri duhet ketë dijeni nëse ndaj tij ka filluar një proces penal dhe, në radhë të dytë, ky duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pjesëmarrja në të. Gjykata arrin në këtë përfundim për arsye se heqja dorë nënkupton një akt vullneti nga ana e të pandehurit, që siç është pranuar nga teoria e së drejtës penale, për të pasur një akt vullnetar duhet të ketë në radhë të parë një proces të brendshëm të perceptimit të realitetit nga ana e të pandehurit dhe më pas një proces të brendshëm vendimmarrjeje prej tij..... Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i mësipërm është i një rëndësie të veçantë, pasi parashikon se janë organet shtetërore ato që duhet të marrin të gjitha masat, nëpërmjet veprimeve aktive, për të siguruar gjykatën se i pandehuri është njoftuar në mënyrë të rregullt, se në ngarkim të tij ka një procedim penal dhe se i pandehuri, pas këtij njoftimi të rregullt, me vullnetin e tij të lirë vendos t'i fshihet drejtësisë. Pra, ky interpretim i nenit 6 të të KEDNJ-së nga ana GJEDNJ-së përbën një garanci procedurale më shumë për shtetasit e vendeve që kanë nënshkruar Konventën...” (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë vendimi nr. 30, datë 17.6.2010).*

83. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se zhvillimi i një procesi në mungesë të të pandehurit kërkon domosdoshmërisht garantimin nga gjykatat të marrjes dijeni efektivisht nga i pandehurit mbi zhvillimin e procedimit kundër tij, si dhe heqjen dorë vullnetarisht dhe në mënyrë të qartë për të marrë pjesë në proces.

84. Kolegjet çmojnë se në të tilla rrethana, në kuptim të nenit 432, shkronja “b” të K.P.Penale, rekursi i paraqitur nga i gjykuari Stilian Vathi gjendet i bazuar në ligj e si i tillë do të pranohet, rrjedhimisht, në bazë të nenit 441, pika 1, shkronja “ç” të këtij Kodi, vendimi nr. 24, datë 13.9.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë do të prishet dhe aktet do të kthehen për rishqyrtim në po atë gjykatë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438, 441 pika 1, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Penale,

#### **VENDOSËN:**

Prishjen e vendimit nr. 24, datë 13.9.2007 të Gjykatës së Apelit Ushtarak Tiranë dhe kthimin e akteve për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Ardian Dvorani (kryesues), Evelina Qirjako, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj, Guxim Zenelaj, Mirela Fana, Andi Çeliku, Medi Bici, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Edmond Islamaj, Tom Ndreca, Artan Broci

#### **VENDIM**

**Nr. 4, datë 6.12.2013**

#### **NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Ardian Nuni	kryesues
Ardian Dvorani	anëtar
Arjana Fullani	anëtare
Evelina Qirjako	anëtare
Andi Çeliku	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar
Shkëlzen Selimi	anëtar
Artan Zeneli	anëtar
Admir Thanza	anëtar
Tom Ndreca	anëtar
Artan Broci	anëtar

Në seancën gjyqësore publike të datës 10.12.2013 morën në shqyrtim çështjen civile nr. 11111-00021-00-2009 akti që u përket palëve:

PADITËS: Haziz Kuka, në mungesë.

AQIF KUKA, në mungesë.

I PADITUR: Ibrahim Lika, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga Av. F. Luli.

K.K.K.PRONAVE QARKU DIBËR,

DREJTORIA E BUJQËSISË MAT,

AGJENCIA KOMBËTARE E PRIVATIZIMIT DIBËR.

Me pjesëmarrjen e Av. Shtetit, A. Deda dhe D. Mustafaj me autorizimin nr. 2108 prot., datë 10.12.2013.

OBJEKTI I PADISË:

Anulimi i vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 i K.K.Pronave Dibër.

Anulimin e kontratës së shitjes nënshkruar midis AKP-së, dega Dibër dhe të paditurit Ibrahim Lika me nr. 60, datë 31.8.2001.

Detyrimi i palës së paditur të na njohë pronar mbi një sipërfaqe toke, të ndodhur në fshatin Urakë prej 9 ha.

**BAZA LIGJORE:** Neni 419, 92 dhe 608 i K.Civil, ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

**Gjykata e Shkallës së Parë Mat**, me vendimin nr. 25, datë 30.1.2002, ka vendosur:

“Rrëzimin e padisë të paditësive, Haziz Kuka e Aqif Kuka, si të pabazuar në ligj e prova.”

**Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 977, datë 3.10.2002, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 25, datë 30.1.2002 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Mat”.

**Gjykata e Shkallës së Parë Mat**, me vendimin nr. 258, datë 10.5.2004, ka vendosur:

“Konstatimin e pavlefshëm të vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 të KKKP-ve Mat, sot KKKP-ja Dibër, si në kundërshtim me ligjin, pasi është i mbështetur në një akt të falsifikuar, shkresën nr. 274/1, datë 20.2.1995 të Arshivës së Shtetit dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme.

Konstatimin e pavlefshëm të kontratës së privatizimit nr. 60, datë 31.8.2001 të lidhur midis AKP-së Dibër dhe të paditurit Ibrahim Lika si në kundërshtim me ligjin dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Rrëzimin e kërkesëpadisë për sa i përket detyrimit për t’u njohur pronar nga i padituri si të pambështetur në ligj dhe në prova”.

**Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 949, datë 4.10.2005, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, në këtë mënyrë:

Rrëzimin tërësisht të kërkesëpadisë”.

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. 164, datë 16.2.2007, ka vendosur:

“Mospranimin e rekursit”.

**Gjykata Kushtetuese**, me vendimin nr. 7, datë 11.3.2008, ka vendosur:

“Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 949, datë 4.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 164, datë 16.2.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, me detyrat përkatëse”.

**Gjykata e Apelit Tiranë**, me vendimin nr. 1823, datë 13.11.2008, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimit të çështjes”.

Kundër vendimit nr. 1823, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë kanë paraqitur *rekurs*

**paditësit Haziz Kuka dhe Aqif Kuka**, me anën e të cilit kanë kërkuar *prishjen e vendimit nr. 1823, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë*, duke parashtruar shkaqet përkatëse:

- *Vendimi i mësipërm është i kundërligjshëm dhe antikushtetues.*

- *Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, me shkresën e saj, i është përgjigjur të paditurit Ibrahim Lika se në arkivat e saj nuk gjendet asnjë dokument në emër të Sul Likës, babait të të paditurit.*

- *Shkresa me të cilën i padituri pretendon se është pronar i kësaj prone është e falsifikuar, pasi këtë gjë e pranon dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.*

- *Ndaj të paditurit në këtë proces, Ibrahim Lika, paditësit kanë bërë kallëzim penal kundër tij në Prokurorinë e Rrethit Mat dhe çështja është dërguar për gjykim në gjykatë duke e akuzuar të paditurin Ibrahim Lika për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. Pas ngjarjeve të vitit 1997, çështja është pushuar për shkak amnistie.*

- *Edhe pse është ndjekur penalisht për veprën penale të mësipërme dhe ka përfutur nga ligji i amnistisë së asaj kohe, i padituri Ibrahim ka përdorur përsëri dokumentin e falsifikuar dhe i është drejtuar Agjencisë së Privatizimit për të privatizuar vaskat e rasatit të peshkut e të objekteve të tjera të ndërmarrjes së peshkimit me të drejtën e parablerjes.*

- *Ndaj të paditurit ka filluar përsëri ndjekja penale nga ana e prokurorisë dhe gjykatat kanë vendosur pushimin e kësaj çështje penale.*

- *Në rastin konkret, Gjykata e Apelit Tiranë, duke mos zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata Kushtetuese, ka diskriminuar edhe njëherë paditësit pasi gjykimi i saj nuk njohu vendimin nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe la në fuqi vendimin e KKKP-së Mat të mbështetur plotësisht në dokumente të falsifikuara.*

- *Me vendimin e saj, gjykata e apelit inkriminoi edhe njëherë të paditurin Ibrahim Lika, pasi ligjëroi dokumentin e falsifikuar të përdorur prej tij, pushoi gjykimin në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, megjithëse ajo ishte kompetente për shqyrtimin e kërkesëpadisë. Gjithashtu, zgjidhja e konflikteve në rrugë gjyqësore është parashikuar si në nenin 32 të K.Pr.Civile, ashtu edhe në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993. Me këtë vendim gjykata e apelit i vuri edhe njëherë palët në pozita të barabarta pasi legjitimoi të drejtën e të paditurit Ibrahim Lika që realizoi përvetësimin e pronës me dokumente të falsifikuara.*

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë** me vendimin nr. s’ka, datë 21.11.2011, pasi shqyrtoi në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga pala paditëse, çmoi se rekursi konkret do të duhet të shqyrtohet nga

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të arritur eventualisht në një unifikim të praktikës gjyqësore, duke shtruar për interpretim njëshues çështjet e mëposhtme:

*I. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, si zgjidhet çështja e kompetencës lëndore të gjykatës?*

*II. Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje administrative dhe do të shqyrtohet nga gjykata administrative, apo do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata civile?*

## **KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË**

Pasi dëgjuan relatimin e gjyqtarëve Admir Thanza dhe Arjana Fullani; në mungesën e palës paditëse; dëgjuan përfaqësuesen e palës së paditur I. Lika, Av. F. Luli, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 1823, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë; dëgjuan përfaqësuesit e Avokaturës së Shtetit A. Deda dhe D. Mustafaj, që deklaruan se për sa i përket unifikimit të praktikës gjyqësore këto gjykime mendojmë se duhet të gjykohen nga gjykata administrative, ndërsa për sa i përket themelit të çështjes nuk shprehemi se është një konflikt mes palëve private; si diskutuan çështjen në tërësi,

### **I. VËREJNË:**

1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, konstatohet se paditësit, Haziz Kuka dhe Aqif Kuka janë trashëgimtarë ligjorë, respektivisht të Ramazan Kukës dhe Rexhep Kukës. Trashëgimlënësi Ramazan Kuka, sipas dokumentacionit të administruar në dosje në vitin 1950, ka pasur në pronësi “Rrahnoja” prej 22.733 m<sup>2</sup>, “Ishulla” 45.969 m<sup>2</sup> dhe “Ishulla” 76.072 m<sup>2</sup>.

2. Edhe trashëgimlënësi tjetër Rexhep Kuka ka pasur në pronësi sipas regjistrimit kadastral të vitit 1950, një sipërfaqe prej 54.000 m<sup>2</sup> në po atë vend.

3. I padituri Ibrahim Lika është njohur nga K.K.K.Pronave Mat me vendimin nr. 1, datë 18.1.1996 pronar për një sipërfaqe toke 90.000 m<sup>2</sup> me emërtim “Rrethe Baz”.

4. Si bazë, KKKP-ja, për njohjen pronar të të paditurit, është bazuar në vendimin nr. 335, datë 22.6.1995 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat (vërtetim fakti), i cili ka vërtetuar gjyqësisht këtë pronë, sipërfaqe toke 90.000 m<sup>2</sup> me emërtim “Rrethe Baz”, në emër të të paditurit, Ibrahim Lika.

5. Pas kësaj, me kontratën e shitjes nr. 60, datë 31.8.2001, i padituri Ibrahim Lika ka privatizuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit vaskat e peshkut, si 9390

dhe objektet e tjera në sipërfaqen e njohur në pronësi.

6. Pala paditëse ka pretenduar se e gjithë pronësia e kthyer në emër të të paditurit Ibrahim Lika dhe ajo e privatizimit nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit është në pronësinë e tyre, pasi K.K.K.Pronave në marrjen e vendimit është bazuar mbi vendimin e gjykatës, vërtetimin e faktit të pronësisë prej 90.000 m<sup>2</sup> dhe një dokumenti të Arkivit të Shtetit, i cili ka qenë i falsifikuar nga i padituri Ibrahim Lika, i përdorur prej tij, dokument i cili është konstatuar si i falsifikuar nga gjykata, është marrë në përgjegjësi penale i padituri dhe me vendimin nr. 38. datë 7.5.2003 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat është pushuar çështja për shkak të amnistie me ligjin nr. 8202, datë 27.3.1997.

7. Gjykatat e faktit në gjykimin dhe rigjykimin e kësaj çështjeje kanë vendosur sa më lart. Së fundmi, **Gjykata e Apelit Tiranë** me vendimin nr. 1823, datë 13.11.2008 ka vendosur: “*Prishjen e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimit të çështjes*”.

8. **Me arsyetimin se:** “*Gjykata e Shkallës së Parë Mat, në kundërshtim me kërkesat e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë dhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksion gjyqësor apo administrativ, nuk e ka parë shqyrtimin e mosmarrëveshjes në këtë këndvështrim ligjor dhe, për rrjedhojë, ka gabuar në përfundimet që ka arritur. Në rastin konkret, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes, megjithëse del qartë se paditësit kërkojnë në objektin e padisë anulimin e vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 të K.K.Pronave dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, pra konstatohet se mosmarrëveshja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ, nuk mban parasysh kërkesat e nenit 59 dhe 468 të K.Pr.Civile. Në këtë rast, gjykata e apelit çmon se ka vend për të prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes*”.

9. **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, me vendimin nr. s’ka, datë 21.11.2011, pasi shqyrtoi në seancë gjyqësore rekursin e paraqitur nga pala paditëse, pas daljes së ligjit nr. 49/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*” dhe hyrjes së tij në fuqi, çmoi se rekursi konkret do të duhet të shqyrtohet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për të arritur eventualisht në një unifikim të praktikës gjyqësore.

10. Çështja konkrete në gjykim ka në objektin e saj disa kërkime si anulim i vendimit të K.K.K.Pronave; Anulim kontratë shitje të realizuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe detyrim njohje pronar.

Në këto rrethana, bazuar në problematikën e çështjes gjyqësore konkrete, e cila ka për objekt disa kërkitime si të natyrës civile dhe administrative, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmoi të nevojshme të shtrojë për diskutim përpara Kolegjeve të Bashkuara, zgjidhjen e çështjes së kompetencës lëndore të gjykatës. Prandaj, në këto rrethana, çmohet e nevojshme interpretimi dhe sqarimi i këtyre çështjeve për t'i dhënë zgjidhje jo vetëm çështjes objekt gjykimi, por edhe për unifikimin e praktikës gjyqësore për çështje të këtij lloji.

## II. LIGJI I ZBATUESHËM:

11. **Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë:** *“E drejta e pronës private është e garantuar. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil”.*

12. **Neni 1 i protokollit 1 të Konventës Evropiane të së Drejtave të Njeriut:** *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij”.*

13. **Neni 163 i Kodit Civil:** *“Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë”.*

14. **Neni 296 i K.Civil:** *“Pronari ka të drejtë të ngrejë padi për të kërkuar sendin e tij nga çdo posedues ose mbajtës. Këtë të drejtë e ka edhe çdo bashkëpronar për sendin e përbashkët, me qëllim që ai t'u dorëzohet gjithë bashkëpronarëve”.*

15. **Neni 14 i K.Pr.Civile:** *“Gjykata ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin”.*

16. **Neni 16§1 i K.Pr.Civile:** *“Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi, që janë të detyrueshme të zbatohen prej saj. Ajo bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët”.*

17. **Neni 55 i K.Pr.Civile:** *“Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”.*

18. **Neni 61 i K.Pr.Civile:** *“Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për gjykimin e çështjes kryesisht ose me kërkesën e palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente”.*

19. **Neni 159 i K.Pr.Civile:** *“Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen shumë kërkitime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkitimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre do të shkaktojë vështirësi të*

*dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç”.*

20. **Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”:**

20.1 **Neni 7 “Gjykatat administrative janë kompetente për:**

a) *mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;*

b) *mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimtimit të organit publik;.....”.*

20.2 **Neni 8 “Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:**

a) *të cilat lidhen me aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;*

b) *shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër”.*

20.3 **Neni 13 “Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit.**

*Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave”.*

20.4 **Neni 23 “Në një kërkesëpadi mund të parashtrihen disa kërkitime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkitimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre shkakton vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç”.**

20.5 **Neni 24 “Kur në një gjykatë janë duke u shqyrtuar padi, në të cilat marrin pjesë po ata persona, si paditës ose si të paditur, ose padi që kanë lidhje midis tyre, gjykata mund t'i bashkojë këto në një gjykim dhe të japë për të gjitha një vendim të përbashkët”.**

21. **Ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve”**

21.1 **Neni 1 “Ky ligj u njeht ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 Nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompensimin e tyre”.**

21.2 **Neni 2 “Për efekt të këtij ligji me pronë kuptohet pasuria e paluajtshme në formën e tokës truall, ndërtesave dhe çdo gjë tjetër që është bashkuar në mënyrë të qëndrueshme me to, si godina banimi, fabrika, punishte, dyqane, magazina e çdo ngrehinë tjetër....**

21.3 **Neni 4** “U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të gjitha pronat që në momentin e daljes së këtij ligji ekzistojnë në formën e trojeve të pazëna apo ndërtesave të pandryshuara, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj”.

21.4 **Neni 21** “Në trojet e zëna me ndërtime shtetërore, si dyqane, magazina, punishte etj., ish-pronarët kanë të drejtën e parablerjes së këtyre objekteve, kur privatizohen me çmimet e përcaktuara sipas dispozitave në fuqi”.

22. **Ligji nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”**

22.1 **Neni 1** “Objekti i ligjit” parashikohet shprehimisht se:

“Ky ligj ka për objekt: rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet apo konfiskimet; kthimin dhe, aty ku sipas këtij ligji kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj; procedurat për realizimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si gjithë organet administrative të ngarkuara për realizimin e tyre”.

22.2 **Neni 2** “E drejta e pronësisë”: “Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë në çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës”.

22.3 **Neni 3** “Përkufizime” “Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

.....2. “Pronë” nënkupton një send të paluajjtshëm, sipas përcaktimit në Kodin Civil;...”.

22.4 **Neni 6** “Njohja e se drejtës së pronësisë dhe kthimi i pronës” “1. Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajjtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompensohet deri në 60 ha dhe kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe.....”.

22.5 **Neni 14** “E drejta e parablerjes” “1. Për pronat e paluajjtshme të zëna me objekte shtetërore, subjektet e shpronësuara kanë të drejtën e parablerjes mbi këto objekte kur ato privatizohen.

2. Subjektet e shpronësuara kanë të drejtë të heqin dorë nga e drejta e parablerjes përkundrejt kompensimit, sipas nenit 11 të këtij ligji”.

### III. KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË VLERËSOJNË SE:

23. Në çështjen gjyqësore në gjykim kemi disa kërkime në objektin e padisë

- “Anulimi i vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 i K.K.Pronave Dibër.

- Anulimin e kontratës së shitjes nënshkruar midis

AKP-së, dega Dibër, dhe të paditurit Ibrahim Lika me nr. 60, datë 31.8.2001.

- Detyrimi i palës së paditur të na njohë pronarë mbi një sipërfaqe toke të ndodhur në fshatin Urakë prej 9 ha”.

24. Në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” nenit 70, pika 5 e tij është përcaktuar se “Data e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative caktohet me dekret të Presidentit të Republikës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë. Ministri i Drejtësisë bën propozimin pasi të jenë plotësuar kërkesat e pikës 2 të këtij neni dhe të ketë marrë më parë mendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

Me dekretin nr. 8349, datë 14.10.2013 të Presidentit të Republikës është caktuar se “Funksionimi i gjykatave administrative fillon më datë 4 nëntor 2013”.

Në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” është përcaktuar kompetenca lëndore e gjykatës administrative.

25. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në problematikën e çështjes gjyqësore konkrete, e cila ka për objekt disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, vlerësojnë se në çdo rast në gjykime të kësaj natyre do të shtrohen për zgjidhje çështje të kompetencës lëndore e gjykatës. Prandaj, në këto rrethana çmohet e nevojshme interpretimi dhe sqarimi i këtyre problematikave për t’i dhënë zgjidhje jo vetëm çështjes objekt gjykimi, por edhe për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore për çështje të këtij lloji.

26. Konkretisht për efekt unifikimi të praktikës gjyqësore Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë shtrojnë për interpretim njësuës çështjet e mëposhtme:

**I. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative, si zgjidhet çështja e kompetencës lëndore të gjykatës?**

**II. Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje administrative dhe do të shqyrtohet nga gjykata administrative apo do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata civile?**

**I. Lidhur me çështjen e parë që është shtruar për unifikim**

27. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se gjykata së cilës i referohet çështja nga pala paditëse, fillimisht duhet të verifikojë nëse ajo është

kompetente nga ana lëndore në varësi të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim.

28. Kompetenca lëndore (*competentia ratione materiae*) është ajo që përcakton gjykatën që ka të drejtë dhe njëkohësisht detyrë të shqyrtojë dhe të zgjidhë mosmarrëveshje të caktuara.

*Gjykata civile* ka kompetencë lëndore të gjykojë çështje civile dhe çështje të tjera (për shkak të llojit, natyrës dhe objektit) të parashikuara sipas K.Pr.Civile dhe ligje të tjera.

*Gjykata administrative* ka kompetencë lëndore të gjykojë çështje administrative të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*".

Ligji nr. 49/2012 nuk është thjesht një ligj organik që rregullon vetëm çështjet e organizimit dhe funksionimit të gjykatave administrative, por ai parashikon edhe parime të përgjithshme të gjykimit administrativ dhe norma procedurale që lidhen me juridiksionin, kompetencën e gjykatave administrative, përbërjen e gjykatave sipas shkallëve të gjykimit dhe natyrës së çështjeve, si dhe fazat procedurale të gjykimit deri në ekzekutimin e vendimit. Pra, në tërësi ky ligj është me natyrë procedurale.

29. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012 dhe më pas fillimin e funksionimit të gjykatave administrative datë 4.11.2013, dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Civile lidhur me gjykimin e çështjeve administrative u shfuqizuan. Në këto rrethana, nuk ka më bazë ligjore të referuar në dispozitat e K.Pr.Civile për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Në nenin 7 të ligjit nr. 49/2012 është përcaktuar kompetenca lëndore e gjykatës administrative. Megjithatë, ligji nr. 49/2012 në nenin 1, pika 2 parashikon se: "*Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe*". Më pas, në nene të veçanta, ligji nr. 49/2012 në mënyrë specifike të referon te parashikimet e dispozitave të K.Pr.Civile, *si elementet procedurale të padisë, palët, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve, njoftimet, rregullat për zhvillimin e seancës gjyqësore, mjetet dhe afatet e ankimit etj.*

30. Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për diskutim para Kolegjeve të Bashkuara, konstatohet se pala paditëse që në formulimin e padisë ka ngritur disa kërkitime.

Referuar dispozitave procedurale si në K.Pr.Civile, ashtu dhe në Ligjin e posaçëm nr. 49/2012, është në disponibilitetin e palës iniciuese të procesit (paditësit) që të bashkojë në një padi disa kërkitime, pra që mund të ngrejë një padi me disa objekte, që quhet *kërkesë padi e përbërë*.

31. Në këto kushte, kur kemi disa kërkitime dhe ato lidhen me mosmarrëveshje të natyrave të ndryshme si civile dhe administrative, atëherë gjykata (para së cilës është paraqitur për zgjidhje mosmarrëveshja), duhet fillimisht të vlerësojë *dy momente*:

Së pari, të vlerësojë nëse ajo (gjykata) ka kompetencë lëndore (*competentia ratione materiae*); dhe, së dyti, të vlerësojë mundësinë e gjykimit të mosmarrëveshjeve të ndryshme në një gjykim të vetëm, kjo e fundit përcaktuar nga lidhja e objekteve mes tyre.

32. Kolegjet e Bashkuara, lidhur me pyetjen e parë unifikuese, kur objektet e gjykimit janë të ndryshme, si të natyrës civile ashtu dhe të natyrës administrative, çmojnë se gjykata fillimisht duhet të konstatojë nëse është në kompetencën e saj lëndore gjykimi i të gjithë kërkitimeve të padisë, por njëkohësisht të vlerësojë me hollësi lidhjen e objekteve mes tyre dhe mundësinë e shqyrtimit në një gjykim të vetëm. Pra, gjykata duhet të zgjidhë dhe të vlerësojë nëse bashkimi i këtyre objekteve në një padi është një *bashkim i thjeshtë* apo një *bashkim i ndërvarur*.

33. Referuar trajtimeve teorike të së drejtës procedurale, mund të themi se kemi *një bashkim të thjeshtë* të disa kërkitimeve (objekteve) në një padi kur ato kanë të përbashkët shkakun e padisë, por zgjidhja e njërit kërkim nuk kushtëzon zgjidhjen e kërkitimeve të tjera. Më konkretisht, paditësi nëpërmjet padisë së ngritur në disponibilitetin e tij ka paraqitur disa kërkitime, zgjidhja e të cilëve nuk kushtëzon zgjidhjen e kërkitimeve të tjera. Pra, gjykata mund të vendosë për disa kërkitime pranimin dhe disa të tjerë rrëzimin e tyre pa u kushtëzuar zgjidhja e njërit kërkim nga zgjidhja e tjetrit. Këto kërkitime mund të ngriheshin dhe veçmas në një padi tjetër.

34. Në nenin 159 të K.Pr.Civile parashikohet se kur gjykata është kompetente për gjykimin e të gjitha kërkitimeve ajo i shqyrton dhe i jep zgjidhje çdo kërkitimi.

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se edhe në këtë rast, pra kur gjykata konkrete konstaton se jemi para një *bashkimi të thjeshtë* të objekteve të padisë dhe ajo është kompetente për gjykimin e të gjithë kërkitimeve, përsëri gjykata është e detyruar të vlerësojë, gjithashtu, nëse shqyrtimi i përbashkët i tyre do të shkaktojë vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit dhe nëse po, gjykata vendos që ato të shqyrtohen veç e veç (neni 159 i K.Pr.Civile apo neni 23 i ligjit nr. 49/2012). Ky parashikim zbatohet kryesisht në rastet kur të gjithë kërkimet janë të së njëjtës natyre mosmarrëveshje dhe nuk shtrohet për diskutim problemi i kompetencës lëndore.

35. Ndërsa, në rast se kërkimet në të njëjtën padi janë të natyrave të ndryshme, pra, civile dhe



administrative, gjykata konkrete në rastin kur kemi *bashkim të thjeshtë* të objekteve të padisë detyrimisht duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore, duke ja kaluar ato gjykatës kompetente (neni 61 i K.Pr.Civile apo neni 13 i ligjit nr. 49/2012).

36. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se situata është ndryshe në rastin kur ndërmjet kërkimeve në të njëjtën padi ekziston një *bashkim i ndërvarur*.

Referuar trajtimeve teorike themi se kemi një *bashkimi të ndërvarur* kur zgjidhja e njërit nga kërkimet në të njëjtën padi, kushtëzon dhe zgjidhjen e njërit apo disa kërkimeve të tjera.

37. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se jo në çdo rast gjykata për shkak moskompetence lëndore duhet të vendosë veçimin e kërkimeve duke ja dërguar ato gjykatës kompetente.

Vlerësimi i mësipërm mbështetet *së pari* në parashikimet e nenit 55 të K.Pr.Civile, që thotë se: “Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore...”, dhe *së dyti* në detyrimin e gjykatës për zbatimin e parimit të një gjykimi të plotë dhe të gjithanshëm, si dhe të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm.

38. Në këto rrethana, gjykata konkrete në rastet e gjykimit të disa objekteve që kanë lidhje të ndërvarur mes tyre dhe kanë të njëjtin shkak padie në një gjykim të vetëm, duhet të vlerësojë ligjin e zbatueshëm që prevalon, për efekt të realizimit të një hetimi tërësor të konfliktit dhe dhënies së një zgjidhje të plotë dhe përfundimtare, gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, si dhe shmangien e mundësisë së gjykimeve kontradiktore në rastet kur objektet e padisë veçohen për t’u gjykuar veç e veç nga trupa gjykues apo gjykata të ndryshme, duke mënjanuar kështu dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike.

39. Çështja që shtrohet pas analizës së mësipërme është se kur kemi disa kërkime si të natyrës civile dhe administrative që zgjidhja e tyre është e ndërvarur nga njëra-tjetra dhe që veçimi i tyre cenon parime të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, pyetja që shtrohet për zgjidhje është se *cila është gjykata kompetente për gjykimin e tyre, ajo civile apo administrative dhe në funksion të kësaj të analizojë përparësitë lidhur me kompetencën e gjykatës civile apo administrative*.

40. Kolegjet e Bashkuara për t’i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme i referohen parimit “*lex specialis derogat generali*”, pra kur në një gjykim zbatohen njëkohësisht dy ligje (*materiale apo procedurale*), atëherë do të zbatohet ligji i posaçëm pasi ai ka prioritet mbi ligjin e përgjithshëm.

Duke zbrërthyer më tej çështjen, Kolegjet e Bashkuara i referohen në funksion të parimit të

mësipërm, parashikimeve në ligjin 49/2012, neni 24 i tij: “Kur në një gjykatë janë duke u shqyrtuar padi, në të cilat marrin pjesë po ata persona, si paditës ose si të paditur, ose padi që kanë lidhje midis tyre, gjykata mund t’i bashkojë këto në një gjykim dhe të japë për të gjitha një vendim të përbashkët”.

41. Sa sipër, në raste të tilla para gjykatës përkatëse do të shtrohet për zgjidhje konstatimi i objektit kryesor dhe ndërvarësisë së tij me objektet e tjera. Më konkretisht, nëse në padi një ndër objektet e saj është dhe anulimi i një akti administrativ, gjykata në përcaktimin e kompetencës së saj lëndore duhet të analizojë *ndërvarësinë* e zgjidhjes së pasojave të këtij akti lidhur me objektet e tjera të padisë.

Në të gjithë rastet e mësipërme zbatohet parimi se gjykimi i një mosmarrëveshje administrative si një gjykim i posaçëm duhet të përthithë gjykimin e një mosmarrëveshje civile si një gjykim i përgjithshëm.

42. Kolegjet e Bashkuara çmojnë se situata është ndryshe në rastet kur nga cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi do të rezultojë se objekti dhe shkaku ligjor i saj të jenë të natyrës civile dhe si rezultat i zgjidhjes së pasojave të çështjes me natyrë civile mund të urdhërohet kryerja e disa veprimeve apo mosveprimeve të caktuara nga ana e organeve të administratës publike, veprime të cilat nuk mund të kryheshin pa u zgjidhur më parë konflikti ndërmjet palëve ndërgjyqëse për sa i përket së drejtës së pretenduar.

43. Në raste të tilla, përcaktuese në klasifikimin e një mosmarrëveshjeje si e natyrës civile apo asaj administrative rezulton të jetë pikërisht objekti dhe shkaku ligjor i kërkesë padisë së paraqitur për shqyrtim.

Në këto rrethana Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se është detyrë e gjykatës të identifikojë natyrën e mosmarrëveshjes objekt gjykimi si e natyrës civile apo asaj administrative duke iu referuar për këtë qëllim kërkimeve dhe shkakat që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar.

44. Në kuptim të përcaktimit të sipërcituar në rast se nga cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi do të rezultojë se kërkimet e shtrura për zgjidhje, si dhe shkaku ligjor i kërkesë padisë së paraqitur për shqyrtim janë të natyrës civile, atëherë kompetente për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata civile, pavarësisht përcaktimit që mund të jetë propozuar nga ana e palëve ndërgjyqëse.

45. Në përfundim të analizës së mësipërme,

Kolegjet e Bashkuara arrijnë në konkluzionin se kur nga objekti dhe shkaku ligjor i padisë mosmarrëveshja objekt gjykimi rezulton të jetë e natyrës civile dhe si rezultat i zgjidhjes së pasojave të çështjes me natyrë civile mund të urdhërohet kryerja e disa veprimeve administrative, si p.sh. urdhërimi i ZVRPP-së për të kryer fshirjen apo regjistrimin e një prone të caktuar, atëherë shqyrtimi i këtyre çështjeve do të jetë në kompetencë të gjykatës civile.

46. Në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me pyetjen e parë arrijnë në interpretimin unifikues se:

**A. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohen nga gjykata se janë një bashkim i thjeshtë i tyre, atëherë referuar nenit 61 dhe 159 të K.Pr.Civile dhe 13 dhe 23 të ligjit nr. 49/2012, gjykata duhet të veçojë objektet që nuk janë në kompetencën e saj lëndore duke ja kaluar ato gjykatës kompetente.**

**B. Kur në objektin e gjykimit ka disa kërtime si të natyrës civile dhe administrative dhe këto kërtime konstatohet nga gjykata se janë një bashkim i ndërvarur mes tyre, atëherë referuar nenit 55 të K.Pr.Civile dhe nenit 24 të ligjit nr. 49/2012 dhe zbatimit të parimit “*lex specialis derogat generali*”, gjykata kompetente është si më poshtë:**

- kur në objektin e gjykimit pala paditëse, ndër të tjera, ka për objekt kundërshtimin e një akti administrativ dhe nga pasojat e aktit prodhohen pasoja civile, në çdo rast kompetente është gjykata administrative;

- kur një ndër objektet e gjykimit është një kërkim me natyrë civile, por që është i lidhur ngushtë me aktin administrativ dhe pasojat e këtij akti kanë ardhur nga vullneti shtetëror, atëherë përsëri gjykatë kompetente është gjykata administrative;

- kur objektet e tjera të padisë jo të natyrës së mosmarrëveshjes administrative janë të ndërvarur nga pasojat e aktit administrativ edhe në këtë rast kjo të çon te kompetenca e gjykatës administrative.

**C. Kur nga objekti dhe shkaku ligjor i padisë mosmarrëveshja objekt gjykimi rezulton të jetë e natyrës civile dhe si rezultat i zgjidhjes së pasojave të çështjes me natyrë civile mund të urdhërohet kryera e disa veprimeve administrative, si p.sh. urdhërimi i ZVRPP-së për të kryer fshirjen apo regjistrimin e një prone të caktuar, atëherë shqyrtimi i këtyre çështjeve do të jetë në kompetencë të gjykatës që shqyrton mosmarrëveshjet civile.**

## **II. Lidhur me çështjen e dytë që është shtruar për unifikim**

47. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje është e domosdoshme që të përcaktohet:

Së pari, thelbi dhe qëllimi i ligjit përkatës (me ndryshimet në vite) për kthim dhe kompensim të pronave ish-pronarëve (*anima legis dhe ratio legis*); dhe

Së dyti, natyra juridike e gjykimit me objekt kundërshtim të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës.

48. Lidhur me sqarimin e thelbit dhe qëllimit të legjislacionit për kthim prone, Kolegjet e Bashkuara çmojnë fillimisht të bëjnë një interpretim sistematik të dispozitave ligjore mbi të drejtën e pronës private dhe atë të kthimit dhe të kompensimit të pronave ish-pronarëve.

49. Pronësia është institut kryesor i së drejtës civile. E drejta e pronësisë është një nga të drejtat themelore të njeriut që gëzon mbrojtje në dispozitat e Kushtetutës. Në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet:

*“1. E drejta e pronës private është e garantuar.*

*2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil...”.*

Gjithashtu, në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se:

*“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.*

50. E drejta e pronës është e garantuar dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar. Ndër të cilat më kryesorja është KEDNJ, që në nenin 1 të protokollit 1 parashikon se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare...”.*

51. Karakteri dhe përmbajtja e së drejtës së pronësisë në kuptimin juridiko-civil është sanksionuar në nenin 149 të Kodit Civil, sipas të cilit *“Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji”.* Pronësia është e drejtë subjektive me karakter pasuror, absolut, real, të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm. Objekt i së drejtës së pronësisë janë sendet. Titullari i së drejtës së pronësisë ka si të detyruar një numër të pakufizuar personash dhe e realizon të drejtën e tij pa ndërmjetësinë e personave të tjerë dhe ka të drejtë të kërkojë sendin nga çdo posedues apo mbajtës i paligjshëm, qoftë ai dhe me mirëbesim.

52. Në ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës ish-pronarëve”, parashikohet shprehimisht se:

Neni 1 - “Ky ligj u njuh ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 Nëntor 1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër, si dhe përcakton mënyrat dhe masat për kthimin dhe kompensimin e tyre”.

Neni 2 - “Për efekt të këtij ligji me pronë kuptohet pasuria e paluajtshme në formën e tokës truall, ndërtesave dhe çdo gjë tjetër që është bashkuar në mënyrë të qëndrueshme me to, si godina banimi, fabrika, punishte, dyqane, magazina e çdo ngrehinë tjetër. Ky ligj nuk përfshin pasurinë e paluajtshme në formën e tokës të trajtuar nga ligji “Për tokën”.

53. Në kuptim të dispozitave ligjore të sipërcituara, kushtet për t’u konsideruar subjekt i shpronësuar rezultojnë të jenë:

- qenia pronar mbi një send të paluajtshëm;
- e drejta e pronësisë t’i jetë hequr në mënyrë të padrejtë nga shteti.

54. Ndërsa në nenin 1 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”, dispozitë kjo e emërtuar “Objekti i ligjit”, parashikohet shprehimisht se:

“Ky ligj ka për objekt: a) rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet apo konfiskimet; b) kthimin dhe, aty ku sipas këtij ligji kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj; c) procedurat për realizimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe organet administrative të ngarkuara për realizimin e tyre”.

Në nenin 2 § 1 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, dispozitë kjo e emërtuar “E drejta e pronësisë”, parashikohet shprehimisht se: “Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë në çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës”.

55. Nga dispozitat e mësipërme rezultojnë se natyra dhe qëllimi i këtyre ligjeve (nr. 7698/1993 dhe 9235/2004) ishte pikërisht kthimi aty ku ishte e mundur, i atyre pronave të marra në mënyrë të padrejtë nga shteti nëpërmjet shtetëzimit, shpronësimit apo konfiskimit sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29.11.1944 ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër.

Për qëllimin e mësipërm me këto ligje u krijuan fillimisht Komisionet Vendore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës dhe pas ndryshimeve ligjore aktualisht funksionon si organ i vetëm Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

Këto komisione janë persona juridikë që, duke iu referuar dhe doktrinës juridike në këtë fushë, kategorizohen si ente publike të posaçme të krijuar me ligj nga e para që ushtrojnë funksione në interes të publikut. Qëllimi për të cilin janë krijuar këto komisione dhe kompetencat e tyre janë të shqyrtojnë kërkesat për kthim kompensim prone duke vendosur rast pas rasti kthimin, njohjen, kompensimin apo dhe rrezimin e tyre.

56. Lidhur me çështjen e mësipërme Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se asaj i është dhënë përgjigje dhe në vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002. Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë analizuar dhe interpretuar natyrën dhe qëllimin e ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, si dhe nocioni kthim prone të përdorur si në titullin e ligjit (*rubrica legis fit lex*), ashtu edhe në përmbajtjen e tij. Në këtë vendim Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se: “... Ligjvënësi me këto akte të rëndësishme normative ka njohur padrejtësinë, shkeljen e të drejtave të pronësisë ish-pronarëve dhe ka vendosur të rinjohë të drejtën e pronësisë së tyre duke ju kthyer pronat e shtetëzuara, të shpronësuara, të konfiskuara apo të marra pa të drejtë në forma të tjera, dhe në pamundësi, duke i kompensuar ato. Këto ligje, duke konsideruar të padrejtë atë që kish ndodhur më parë, parashikuan kthimin e të drejtave të pronarëve mbi pronën, kur objekt i saj ishin sende të paluajtshme.

..... Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i konsiderojnë këto akte ligjore që u drejtohen ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre, jo si mënyrë të re të fitimit të pronësisë në favor të tyre, por si mjete që mbrojnë dhe garantojnë të drejtën e pronësisë dhe e bëjnë efektive atë duke e bazuar edhe në argumente analogjie.

Si në titullin e ligjit (*rubrica legis fit lex*), ashtu edhe në përmbajtjen e tyre, përdoret nocioni kthim i pronës. Me fjalë të tjera, kthimi i pronave ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre është thelbi dhe qëllimi i këtyre ligjeve (*anima legis dhe ratio legis*).

Nocionin kthim i pronës ose, me saktë, kthim i sendit objekt i së drejtës së pronësisë, Kodi Civil e përmend në rastin e padisë për kërkimin e sendit (*actio rivendicatio*), neni 296 e vijues i tij. Në rastin kur pranohet padia e rivendikimit, poseduesi jopronar duhet t’i kthejë sendin paditësit në favor të të cilit është njohur e drejta e pronësisë.

Praktika gjyqësore, ashtu edhe literatura juridike,

në këto raste nuk kanë vënë kurrë në dyshim ekzistencën e së drejtës së pronësisë të pronarit joposedues mbi sendin objekt të padisë së rivendikimit. Pronari joposedues nuk ka humbur për asnjë moment titullin e së drejtës së pronësisë, por vetëm posedimin e sendit. Pikërisht kjo është arsyeja pse ligji e kthen atë në situatën e mëparshme duke i njohur të drejtën e kthimit edhe të frutave të sendit (*restitutio in integrum*), dhe kur kjo nuk është e mundur, pranon vetëm kthimin e sendit (*restitutio in parte*).

57. Sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, lidhur me thelbin dhe qëllimin e legjislacionit për kthimin dhe kompensimin e pronës, vlerësojnë se pavarësisht formës së zgjedhur qëllimi si në Shqipëri ashtu edhe në gjithë vendet e lindjes ka qenë i njëjtë, *rivendosija në vend e së drejtës së pronësisë* të ish-pronarëve, pronat e të cilëve ishin marrë padrejtësisht nga shteti, duke shfuqizuar në këtë mënyrë *ipso lege* të gjitha aktet e mëparshme ligjore me të cilat u ishte marrë prona padrejtësisht, duke synuar rregullimin në masën më të mundshme të situatës së paligjshmërisë lidhur me të drejtën e pronësisë. Këto ligje nuk konsiderohen si mënyra të reja fitimi pronësie për shkak se në bazë të tyre siç u citua edhe më lart synohej kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, në të gjitha ato raste kur ishte e mundur, duke u kthyer atyre të njëjtat prona që u ishin marrë në mënyrë të padrejtë nga ana e shtetit të asaj kohe dhe jo prona të tjera.

58. Kolegjet e Bashkuara, lidhur me çështjen tjetër se cila është natyra juridike e gjyqësorëve me objekt kundërshtim të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo të Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, çmojnë ta analizojnë referuar praktikës unifikuese dhe të zakonshme të Gjykatës së Lartë, asaj të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, si dhe vendimmarrjen e GJEDNJ-së në këtë fushë.

59. Në vendimin unifikues nr. 24, datë 13.3.2002, Kolegjet e Bashkuara janë shprehur se: “Në kohën e daljes së kuadrit ligjor për kthimin e pronave ish-pronarëve, ligjvënësi mund të parashikonte edhe rrugën gjyqësore të kërimit dhe kthimit të pronave të shtetëzuara apo konfiskuara padrejtësisht, por çmoi më të përshtatshme rrugën administrative dhe të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve administrative të ngarkuara për këtë qëllim. Në rastin se do të pranohej zgjidhja e parë edhe analogjia do të ishte më e dukshme. I njëjti parashikim ligjor rezultoi të jetë bërë edhe në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

60. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në një rast të tillë pavarësisht se procesi i njohjes, kthimit apo kompensimit të pronave rezultoi t’i jetë besuar një organi administrativ sikurse ishin më parë Komisionet

e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-pronarëve dhe aktualisht Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, veprimtaria e këtyre organeve administrative nuk është konsideruar asnjëherë si veprimtari e mirëfilltë administrative, por si një veprimtari e cila paraqiste dhe paraqet karakteristikat e një veprimtarie gjyqësore.

E thënë ndryshe fakti se nga ana e ligjvënësit procesi i njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave rezultoi t’i jetë besuar një organi administrativ nuk mund të pasjellë përfundimin se edhe gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të këtyre organeve administrative duhet të konsiderohen si gjykime administrative.

61. Kolegjet e Bashkuara çmojnë (siç do të analizohet edhe më poshtë) se në këto lloj gjykimesh nuk kemi të bëjmë me një kontroll të thjeshtë të një veprimtarie administrative. Kontrolli gjyqësor në këto gjykime i kalon caqet e kontrollit të një veprimtarie administrative. Nga ana e gjykatës merret në analizë jo vetëm e drejta e pronësisë, por edhe mënyra e fitimit të pronësisë duke iu referuar për këtë qëllim instituteve të së drejtës civile që kanë rregulluar të drejtën e pronësisë në kohë të ndryshme.

62. Në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara nr. 25/2003 lidhur me subjektet që legjitimohen proceduralisht si paditës, thuhet se: “... ndërsa në grupin e parë përfshihen subjektet që kërkojnë rivendosjen apo kompensimin e të drejtave të tyre si ish-pronarë (trashëgimtarë të ish-pronarëve), në grupin e dytë të subjekteve të legjitimuar proceduralisht përfshihen ato subjekte që kundërshtojnë, në emër të së drejtave apo interesave të tyre të ligjshme, përfitimet e paligjshme që mund të kenë realizuar subjektet e grupit të parë nëpërmjet vendimeve të komisioneve të pronave”.

Pra, në analizë të konkluzioneve të mësipërme mund të thuhet se në gjykimet me objekt kundërshtimin në gjykatë të vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-pronarëve legjitimohen si paditës jo vetëm personat që i janë drejtuar Komisionit, por edhe persona të tjerë të cilët janë cenuar në të drejta apo interesin e tyre të ligjshëm nga vendim-marrja e komisionit.

63. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 4/2005 kanë arritur në përfundimin unifikues se: “Pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjithë rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave është ngritur nga persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve”.

64. Në vendimin unifikues nr. 7/2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: *“... të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, që janë marrë në zbatim të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ”.*

65. Në vendimin unifikues 2/2009 Kolegjet e Bashkuara kanë mbajtur qëndrimin se: *“Ankimi administrativ parashikuar në nenin 18 të ligjit “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” duhet kuptuar dhe zbatuar njëjllë si për ankimet nga subjekti kërkues që ndjek procedurën e plotë administrative dhe nuk paraqiten subjekte të tjerë kërkuese, ashtu dhe për ankimet nga një subjekt i ri pretendues kundër aktit administrativ të dhënë në favor të një subjekti tjetër, por që prek interesat e tij për të njëjtën pronë dhe nuk ka qenë palë në procedurën e plotë administrative të nxjerrjes dhe ankimit të aktit. Në të dyja rastet, subjektet e shpronësuar janë të detyruar të ndjekin procedurat e ankimit administrativ dhe vetëm pasi të jetë ezauruar plotësisht kjo rrugë ligjore, mund t’i drejtohen gjykatës”.*

66. Ndërsa në vendimin unifikues nr. 2/2011, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë ndryshuar qëndrim nga vendimi unifikues nr. 2/2009, duke unifikuar praktikën me sentencën unifikuese se: *“... subjektet e shpronësuar kanë detyrimin që t’i drejtohen organit administrativ, pra AKKP-së, vetëm në dy situata.*

*Së pari, në rastin kur subjektet e shpronësuar paraqesin për herë të parë kërkesë për njohjen dhe kthimin e pronës në cilësinë e ish-pronarit.*

*Së dyti, në rastin e ankimit ndaj vendimit të dhënë në emër të tyre e mbi kërkesën e tyre nga (ish) Zyra Rajonale e AKKKP-së, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” (i ndryshuar).*

*Gjithsesi, edhe në këto dy raste, çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, pra detyrimi për t’iu drejtuar rrugës përkatëse administrative të kërkesës dhe ankimit nuk ekziston, nëse nga subjekti i shpronësuar pretendohet që, për të njëjtën pronë, ish-KKKP-të apo AKKP-ja, kanë disponuar më parë për njohjen e kthimin e pronës një subjekti tjetër të shpronësuar”.*

67. Kolegjet e Bashkuara, referuar vendimeve të mësipërme unifikuese, vlerësojnë se gjykimet me objekt kundërshtim të vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës apo të Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk janë gjykime që përfshihen në rrethin e atyre çështjeve që i përkasin

fushës administrative, por mosmarrëveshje të natyrës civile, në të cilat subjekti pretendues kërkon të drejtën e pronës mbi një send të paluajtshëm, duke paraqitur për këtë qëllim prova në mbështetje të kësaj të drejte.

68. Në këndvështrim të përcaktimit të sipërcituar, në të gjitha ato raste që subjekti i shpronësuar cenohet nga vendimet e ish-KKKP-ve apo të AKKP-së me anë të të cilëve rezultojnë të jetë disponuar më parë për pronësinë mbi sendin e paluajtshëm të pretenduar prej tij në favor të një subjekti tjetër pretendues, nuk ka detyrimin për t’iu drejtuar më parë rrugës administrative por ka të drejtë t’i drejtohet drejtpërdrejt rrugës gjyqësore për të kërkuar të drejtën e tij të pronësisë, karakteristikë kjo e cila e bën të dallueshme nga gjykimi administrativ. Ndërsa, referuar dispozitave të K.Pr.Administrative, ezaurimi i procedurës së ankimit administrativ ndaj aktit të kontestuar është rrugë e detyrueshme para se pala t’i drejtohet juridiksionit gjyqësor.

69. Kolegjet e Bashkuara lidhur me pyetjen e dytë unifikuese i referohen edhe praktikës gjyqësore të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për rastet lidhur me konfliktet e kompetencës territoriale në çështjet me objekt kundërshtim të vendimit të K.K.K.Pronave apo të A.K.K.Pronave.

Në këto gjykime Kolegji Civil, në përcaktimin e kompetencës tokësore për shqyrtimin e këtyre çështjeve në varësi të natyrës së këtij gjykimi, objektit dhe shkakut ligjor të padisë, ka vendosur se duhet të zbatohen parashikimet e nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me kompetencën tokësore: *“Paditë për të drejta reale mbi sende të paluajtshme, për pjesëtimin e sendeve të përbashkëta dhe për posedimin ngrihen në gjykatën e vendit ku ndodhen sendet ose pjesa më e madhe e tyre...”* dhe jo parashikimet e nenit 327 të K.Pr.Civile, që thotë se: *“Padia kundër një akti administrativ shqyrtohet nga seksioni përkatës i gjykatës, në zonën e së cilës ka qendrën organi administrativ, ndaj të cilit drejtohet padia”* (përmenden disa nga vendimet: nr. 429, datë 6.10.2011; nr. 314, datë 14.6.2012; nr. 397, datë 20.9.2012; nr. 2179, datë 3.10.2013).

70. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë, gjithashtu, se edhe GJEDNJ-ja në vendimet e saj thekson se kjo mosmarrëveshje është e natyrës civile. Kështu në vendimin e GJEDNJ-së *“Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, në §36 dhe §77, kjo gjykatë vëren se: “§36. .... mosmarrëveshja lidhur me këtë të drejtë, e cila për nga natyra është një e drejtë civile, është një mosmarrëveshjeje ndërmjet shtetit dhe ankuesit, për të përcaktuar të drejtën e tij të pronësisë. Nëpërmjet vendimeve të Komisionit kompetent për çështjen në fjalë, shteti u njohu të drejtën e kompensimit ankuesve....*

§77. Gjykata vëren se në jurisprudencën e saj ajo ka shqyrtuar mosekzekutimin e një vendimi që njeh një titull pronësie, në kuadrin e fjalisë së parë të nenit 1 protokollit 1 (shiko *Burdov v. Russia*, nr. 59498/00, § 40, ECHR 2002-III, *Jasiūnienė v. Lithuania*, nr. 41510/98, § 45, 6 Mars 2003; *Sabin Popescu v. Romania*, nr. 48102/99, § 80, 2 Mars 2004; dhe *Beshiri dhe të tjerë, i cituar më sipër § 99*). Rrethanat e çështjes konkrete janë të ngjashme me ato të çështjeve të sipërpërmendura dhe për këtë arsye ndërhyrja duhet trajtuar në kuadrin e fjalisë së parë të paragrafit të parë të nenit 1 protokollit 1, i cili përcakton parimin e gëzimit të qetë të pronës në terma të përgjithshme.

Për të mos i cituar të gjitha vlerësimet e GJEDNJ-së në këtë vendim, përmenden konkluzionet në § 45, 50-52, 79-84 (ky vendim ka shërbyer si referencë pothuaj në çdo gjykim kundër Shqipërisë).

Në këtë frymë, GJEDNJ-ja argumenton dhe në çështjet e tjera si Nuri kundër Shqipërisë, Hamzaraj nr. 1 kundër Shqipërisë dhe në vendimin pilot Puto kundër Shqipërisë etj.

71. Edhe në çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, § 134-136, GJ.E.D.NJ. thekson se: “§134. .. se një ankues mund të pretendojë shkelje të nenit 1 të protokollit nr. 1 vetëm në masën që vendimet e kundërshtuara lidhen me “pronat” e tij brenda kuptimit të kësaj dispozite.

“Pronat” mund të jenë ose “prona ekzistuese” ose pasuri, duke përfshirë pretendimet në lidhje me të cilat ankuesi mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “pritshtëri të ligjshme” të përfundimit të gëzimit efektiv të një të drejte pronësie (...).

§135. Gjykata vëren më tej se neni 1 i protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet sikur vendos ndonjë detyrim të përgjithshëm ndaj palëve kontraktuese për të kthyer pronën që u ishte transferuar atyre përpara se të ratifikonin Konventën (...).

§136. Nga ana tjetër, nëse një shtet kontraktues që ka ratifikuar Konventën, duke përfshirë protokollin nr. 1, miraton legjislacion që parashikon kthimin e plotë ose të pjesshëm të pronës së konfiskuar sipas një regjimi të mëparshëm, ky legjislacion mund të konsiderohet se sjell një të drejtë të re pronësie të mbrojtur nga neni 1 i protokollit nr. 1 për personat që përmbushin kërkesat e pranueshmërisë...”

72. Kolegjet e Bashkuara lidhur me çështjen e mësipërme të shtruar për zgjidhje kanë parasysh dhe konkluzionet e arritura në vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht në këtë vendim Gjykata Kushtetuese analizon natyrën e këtyre gjykimeve si më poshtë: “... Kërkesa e një personi para organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave ... është një e

drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë, nga ana tjetër, se vendimet e KKKP-së dispononin drejtpërsëdrejti mbi të drejta subjektive, të cilat janë ekskluzive të titullarëve të caktuar dhe jo të shtetasve apo publikut në tërësi siç janë interesat publikë. Ky fakt mund të konstatohet nga gjykata pasi e drejta e një personi për t’u njohur si pronar i një sendi rregullohet nga Kodi Civil, si rrjedhim gjykata çmon se jemi jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike e cila rregullon veprimet e organeve shtetërore në mbrojtje të interesave publikë.

...vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termit (*strictu sensu*), por akte “sui generis” të nxjerra nga një organ sui generis, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë.

...Në këto kushte kur një person vinte në lëvizje me kërkesë të KKKP-së, kjo kërkesë ishte e barasvlershme si të ishte bërë para gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje që të krijonte tek individit të njëjtën pritshtëri që krijon një vendim gjyqësor, i cili i njeh individit pronësinë mbi një send. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Viasu kundër Rumanisë, Ramadhi, apo Hamzaraj, kundër Shqipërisë*, duke barazuar vendimin e KKKP-së me një vendim gjyqësor i cili krijon pritshtërinë e ligjshme tek individit se ose do të vihet në posedim të pronës, ose do të dëmshpërblehet...”.

73. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbështetur në analizën e mësipërme vlerësojnë se në gjykimet me objekt kundërshtim të vendimit të K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave kemi të bëjmë me të drejta subjektive, edhe pse enti shtetëror publik KKKP (sot A.K.K.Pronave) shpreh vullnetin e tij nëpërmjet vendimeve të marra pas kërkesës së bërë nga subjektet përkatëse. Vendimet e tyre nuk trajtohen dhe nuk goditen në gjykatë si akte të mirëfillta administrative. Subjekti kërkues në një gjykim të zakonshëm kundërshton vendimin e K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave dhe kërkon të drejtën e pronës duke paraqitur prova në mbështetje të së drejtë së tij të pronësisë.

Në këto gjykime, gjykata zhvillon një gjykim themeli lidhur me titullin e pronësisë duke ndryshuar apo shfuqizuar vendimin e K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave, si dhe duke zgjidhur në themel këtë konflikt që është një konflikt pronësie, pra i natyrës civile. Për këtë arsye legjislatori e kishte pajisur procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave me garanci në mënyrë që të drejtat e shtetasve të kishin një mbrojtje maksimale në gjykatë.

74. Kolegjet e Bashkuara, në mbështetje të përfundimit të mësipërm se, gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimeve të ish-Komisioneve të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve dhe të vendimeve të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave janë gjykime të natyrës civile, çmojnë të analizojnë dispozitat që rregullonin dhe rregullojnë aktualisht vendimmarrjen e gjykatës në gjykimin administrativ. Për këtë Kolegjet e Bashkuara çmojnë të bëjnë një analizë “*a contrario*”.

Konkretisht, në qoftë se do t'i referohemi parashikimeve të nenit 331 të K.Pr.Civile (aktualisht i shfuqizuar), seksioni administrativ i posaçëm i gjykatës përkatëse në gjykimin administrativ, sipas nenit 324 (kompetenca lëndore), në vendimin përfundimtar *inter alia* mund të vendosë edhe: “...detyrimin e organit përkatës për të nxjerrë një akt administrativ, në përputhje me ligjin, ose për marrjen e masave për rivendosjen e së drejtës së cenuar;...”.

Ndërsa po t'i referohemi nenit 40 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, gjykata administrative *inter alia* mund të vendosë edhe:

“...b) ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht të aktit administrativ, ose detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;

....ç) detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit;

...e) detyrimin e organit publik për të kryer një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;...”.

75. Kolegjet e Bashkuara, në analizë të sa më sipër, vlerësojnë se në gjykimin e mosmarrëveshjes që ka për objekt kundërshtimin e vendimit të K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave, gjykata nuk mund të vendosë asnjë nga urdhërimet e mësipërme në vendimin e saj përfundimtar. Gjykata në vendimin e saj përfundimtar vendos shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të K.K.K.Pronave apo A.K.K.Pronave dhe zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes lidhur me të drejtat e pronësisë së pretenduara nga palët.

76. Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se shqyrtimi i mosmarrëveshjeve me objekt kundërshtim të vendimit të K.K.K.Pronave lidhet me të drejta subjektive dhe synon njohjen e së drejtës së pronës mbi sende të caktuara, prandaj ky gjykim mund të bëhet vetëm nga gjykatat e zakonshme civile në përputhje me dispozitat e K.Civil dhe të K.Pr.Civile.

77. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të

Gjykatës së Lartë lidhur me pyetjen e dytë arrijnë në interpretimin unifikues të praktikës gjyqësore se:

**Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile.**

### **III. Lidhur me zgjidhjen e çështjes në gjykim**

78. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes në gjykim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë të parashtrajnë opinionin e tyre në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e saj nr. 1823, datë 13.11.2008, e cila ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimin të çështjes”. Ky vendim është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe si i tillë ai duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim.

79. Gjykata e Apelit Tiranë ka rishqyrtuar këtë çështje pas vendimit nr. 7/2008 të Gjykatës Kushtetuese, që ka vendosur: “Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 949, datë 4.10.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr. 164, datë 16.2.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit). Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë”.

Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se: “Mohimi i së drejtës së aksesit, domethënë i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare nga ajo lidhur me pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane.....gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë pa e zgjidhur çështjen në themel, pra pa u dhënë përgjigje kërkesave për pavlefshmërinë e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave dhe lidhur me këtë dhe kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes së objekteve mbi këtë sipërfaqe dhe kthimin në gjendjen e mëparshme. Rrëzimi i padisë nga gjykata, pa dhënë një vendim përfundimtar, megjithëse mund të arsyetohet me mungesën e juridiksionit dhe të legjitimitetit, mund t’u heqë kërkuarve mundësinë të vënë përsëri në lëvizje gjykatën dhe të marrin përgjigje përfundimtare për problemet e themelit të çështjes.

80. Në këtë vendim Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e saj nuk jep asnjë konkluzion nëse kjo çështje është apo jo në juridiksionin gjyqësor, por shprehet se rrëzimi i padisë nga gjykata e apelit për mungesë juridiksioni gjyqësor mund t’i heqë mundësinë paditësit të vërë përsëri në lëvizje gjykatën, pasi në këtë rast do jemi para gjësë së gjykuar.

81. Gjykata e Apelit Tiranë me vendim nr. 1823, datë 13.11.2008 ka vendosur:

*“Prishjen e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimit të çështjes”, me arsyetimin se: “... Gjykata e Shkallës së Parë Mat, në kundërshtim me kërkesat e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, gjykata, në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë dhe kryesisht, merr në shqyrtim nëse çështja që shqyrton bën pjesë në juridiksion gjyqësor apo administrativ, nuk e ka parë shqyrtimin e mosmarrëveshjes në këtë këndvështrim ligjor dhe për rrjedhojë ka gabuar në përfundimet që ka arritur”.*

*Në rastin konkret, gjatë shqyrtimit të mosmarrëveshjes, megjithëse del qartë se paditësit kërkojnë në objektin e padisë anulimin e vendimit nr. 1, datë 18.1.1996 të K.K.K.Pronave dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, pra konstatohet se mosmarrëveshja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ, nuk mban parasysh kërkesat e nenit 59 dhe 468 të K.Pr.Civile. Në këtë rast, gjykata e apelit çmon se ka vend për të prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe të vendoset pushimi i gjykimit të çështjes.*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi i mësipërm i gjykatës së apelit është marrë në zbatim të gabuar të ligjit.

82. Në vendimin unifikues nr. 4 të vitit 2005 Kolegjet e Bashkuara kanë arritur në përfundimin unifikues se: *“Pavarësisht nga momenti i regjistrimit të çështjes për gjykim (para apo pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri), në të gjithë rastet kur padia për kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave është ngritur nga persona të tjerë që kanë fituar të drejta pronësie mbi pronat e trajtuara nga ky vendim, është gjykata ajo që ka juridiksionin për shqyrtimin e këtyre çështjeve”.*

83. Gjithashtu, dhe në vendimin unifikues nr. 7/2005, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se: *“... të gjitha çështjet, të cilat kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të Komisioneve të Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, që janë marrë në zbatim të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 dhe që janë kundërshtuar në gjykatë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, janë në juridiksionin gjyqësor dhe jo në atë administrativ”.*

84. Kolegjet e Bashkuara, lidhur me çështjen në gjykim, konstatojnë se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e kësaj çështje është ligji nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve”. Në këto kushte gjykata e apelit, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes, me

arsyetimin se mosmarrëveshja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor por në atë administrativ, ka keqzbatuar ligjin.

85. Kolegjet e Bashkuara, referuar interpretimit ligjor dhe atij të bërë në vendimet e mësipërme unifikuese, vlerësojnë se çështja konkrete është në juridiksionin gjyqësor dhe ajo duhet kthyer për rigjykim në gjykatën e apelit.

Në rigjykim, gjykata e apelit, për t’iu dhënë zgjidhje problemeve të mësipërme, në respektim të së drejtave të palëve dhe detyrimeve të tyre që rrjedhin nga procesi gjyqësor civil, *“... ka për detyrë që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin (neni 14) dhe, duke bërë një “cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen” ta zgjidhë atë “në përputhje me dispozitat ligjore dhe normat e tjera në fuqi” (neni 16) dhe t’i japë çështjes një zgjidhje përfundimtare.*

86. Përfundimisht, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se rekursi i paraqitur nga pala paditëse *Haziz Kuka dhe Aqif Kuka* është i bazuar në ligj, prandaj si i tillë ai duhet të pranohet dhe për rrjedhojë vendimi i gjykatës së apelit duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për t’u rishqyrtuar nga një trup tjetër gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 485/c të K.Pr.Civile,

#### **VENDOSËN:**

Prishjen e vendimit nr. 1823, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.

Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 10.12.2013

Anëtarë pro: Andi Çeliku, Majlinda Andrea, Mirela Fana, Medi Bici, Shkëlzen Selimi, Admir Thanza, Artan Broci, Tom Ndreca.

Anëtarë kundër: Ardian Nuni (kryesues), Arjana Fullani, Ardjan Dvorani, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj, Artan Zeneli

#### **MENDIMI I PAKICËS**

1. Ne gjyqtarët në pakicë, Ardian Dvorani, Ardian Nuni, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj, Artan Zeneli vlerësojmë se qëndrimi i shumicës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka arritur në përfundimin njësores se kur



objekti i gjykimit është kundërshtimi i vendimi të ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, çështja do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata civile, nuk është në përputhje me ligjin.

2. Për të treguar arsyet, pakica vlerëson të përcaktojë llojin e aktit që nxjerr ish-KKKP/AKKP, si dhe natyrën e së drejtës së krijuar dhe disponuar nëpërmjet këtij akti, duke mbajtur parasysh jo vetëm jurisprudencën, e pasur tashmë, të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, por dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

3. Në referencë të kësaj jurisprudence vihet re se ajo ka evoluar ndër vite, duke mbajtur qëndrimin se e drejta për pronë, në kuptimin kushtetues dhe të rregullave të së drejtës ndërkombëtare, nuk identifikohet me rikthimin tërësisht të pronës së marrë nga ana e regjimeve totalitare. Procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave në vendet e tranzicionit paskomunist, aq sa bazohet në të drejtën e pronës, bazohet dhe në parimin e ndershmërisë dhe të drejtësisë dhe, për më tepër, në parimin e shtetit social. Këtij qëndrimi i është përmbajtur përgjithësisht praktika e të gjithë vendeve që janë ndeshur me të njëjtin fenomen.

4. Pra, e drejta e pronës nuk njësohet tërësisht me të drejtën e kthimit dhe/ose kompensimit të saj. Ky është kuptimi edhe i nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili mbron vetëm zotërimet ekzistuese të personit dhe nuk garanton të drejtën e fitimit të zotërimeve. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për këto çështje i përmbahet qëndrimit se *“nuk përbën pasuri bindja për ekzistencën e së drejtës së pronësisë, e cila për një kohë të gjatë nuk është shfrytëzuar në mënyrë të efektshme”*.<sup>1</sup> Ky nen i Konventës Evropiane garanton të drejtën e gjithsecilit për zgëzimin në mënyrë paqësore të pasurive të tij, dhe rrjedhimisht aplikohet vetëm për pasuritë ekzistuese të personit.<sup>2</sup>

5. Në kuptim të dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *pasuri për efekt të zbatimit të legjislacionit për njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin konsiderohet ajo ç’ka është kthyer si administrativisht, ashtu edhe gjyqësisht, në mënyrë përfundimtare*, vetëm pas këtyre procedurave, çdo ndërhyrje që prek padrejtësisht këtë pasuri i jep shkas kërkesës për zbatim të nenit 1 të

protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

6. Duke marrë në konsideratë vlerësimet e dhëna nga GJEDNJ-ja në çështjen pilot *Maria Atanasiu dhe të tjerë kundër Rumanisë*, evidentohet se për qëllim të orientimit të zgjidhjeve të çështjeve që parashatrojnë problematika të njëjta të kthimit dhe kompensimit të pronave, kjo gjykatë ka bërë një analizë krahasuese të legjislacionit lidhur me kthimin dhe kompensimin e pronave të shtetëzuara përpara vitit 1989 në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe ka arritur në përfundime se: *“Shumica e vendeve në fjalë e kufizojnë të drejtën e kthimit ose të kompensimit për disa kategori të caktuara të pronave ose kërkesve. Në disa vende legjislacioni përcakton afate, ndonjëherë shumë të shkurtër, për depozitimin e kërkesave....Disa vende ofrojnë forma të ndryshme të kthimit dhe/ose kompensimit me anë të të ashtuquajturve ligje të “kthimit”: ky është rasti në Shqipëri, Bullgari, Lituani dhe “ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë”. Vende të tjera e kanë trajtuar çështjen e kthimit në bazë të ligjeve të rehabilitimit (Republika Çeke, Gjermania, Moldavia, Rusia, Sllovakia dhe Ukraina). Së fundi, çështja është trajtuar, gjithashtu, në legjislacionin e pronave (Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Gjermania dhe Sllovenia). Por në të gjitha rastet, “kthimi” nuk është një e drejtë absolute, por mund të jetë subjekt i kushteve dhe kufizimeve të shumta. E njëjta gjë vlen dhe për të drejtën për kompensim..... Organet përgjegjëse për të vendosur mbi pretendimet për kthim ose kompensim mund të jenë organe gjyqësore ose administrative. Rregullimet më të zakonshme përcaktojnë trupa (panelet) të veçanta për kthimin dhe kompensimin (Shqipëria, Bullgaria, Moldavia dhe Mali i Zi), organet administrative (Lituania), Ministria e Financave ose Drejtësisë, apo edhe gjykatat (Republika Çeke). Në të gjitha vendet e monitoruara, vendimet e organeve administrative mund të ankimohen përpara gjykatave civile ose administrative.*

7. Në krahasim të dy praktikave të cituara më lart, lidhur me kthimin e pronës dhe/ose kompensimin, evidentohet se në krahasim të procedurave gjyqësore të zakonshme, të individualizuara apo programeve administrative të ndërtruara specifikisht për të trajtuar këto lloj pretendimesh, këto të fundit vlerësohen si zgjidhja më efektive e këtyre pretendimeve. Pasi mundësia e trajtimit të kërkesave të shumta në numër është më efektive nëse kalon nëpërmjet procedurave administrative, të cilat eliminojnë barrën e provës, ndryshe nga ato gjyqësore, ku kjo i rëndon kërkesit/aplikuesit. Në këtë mënyrë, kërkesit përballen me kërkesa minimale për barrën e provës, kosto dhe zvarritje të reduktuara dhe më pak pasiguri

<sup>1</sup> Marek Antoni Novicki: Rreth Konventës Evropiane, faqe 344, referuar në vendimin “princi Hans-Adam II i Lihtenshtejnit kundër Gjermanisë, i datës 12.7.2001, Dhoma e Madhe, ankesa nr 42527/98, par. 83.

<sup>2</sup> Monica Carss-Frisk: E drejta e pronës; Manuali e të drejtave të njeriut, nr. 4; Një udhëzues për zbatimin e nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, 2001, faqe 19.

lidhur me të provuarin e kërkimeve, përparësi këto me procesin administrativ në raport me ato gjyqësore.

8. Për këtë arsye, edhe ligjvënësi shqiptar në vlerësimin e avantazheve dhe disavantazheve të alternativave legjislativë, ka çmuar që procesin e kthimit dhe kompensimit të pronës t'ia "besojë" një organi publik siç ishte KKKP-ja, aktualisht AKPP. Qëndrim ky i evidentuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara në vendimin njësuës nr. 24, datë 13.3.2002, ku shprehen se: *"Në kohën e daljes së kuadrit ligjor për kthimin e pronave ish-pronarëve, ligjvënësi mund të parashikonte edhe rrugën gjyqësore të kërimit dhe kthimit të pronave të shtetëzuara apo konfiskuara padrejtësisht, por çmoi më të përshtatshme rrugën administrative dhe të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimeve të organeve administrative të ngarkuara"*.

9. Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 30/2005 ka vlerësuar se *"Parimi i drejtësisë kërkon që të merren në konsideratë jo vetëm interesat e ish-pronarëve dhe të trashëgimtarëve të tyre (subjektet e shpronësuar), por gjithashtu edhe ato të anëtarëve të tjerë të shoqërisë, si edhe interesi publik në tërësi. Kështu, parimi i drejtësisë dhe ai i proporcionalitetit nuk kërkon të kthejnë të drejtat e pronësisë për të gjithë ish-pronarët a trashëgimtarët e tyre apo t'i kompensojë ata me vlerën e plotë"*.<sup>3</sup>

10. Objektivi i kthimit dhe/ose i kompensimit të pronës nuk është fshirja e të gjitha padrejtësive, por zvogëlimi i tyre. Kthimi i të drejtave të pronës nuk duhet të shkaktojë padrejtësi të tjera.<sup>4</sup> Nga kjo pikëpamje, rregullimi i kthimit dhe kompensimit të pronës në origjinën e vet, synon të korrigjojë, për aq sa është e mundur "brenda mundësive dhe kushteve ekonomiko-sociale të vendit", padrejtësitë e regjimit të kaluar të kryera në dëm të pronës private, nëpërmjet shtetëzimeve, shpronësimeve, konfiskimeve ose me çdo mënyrë tjetër të padrejtë.<sup>5</sup>

*Në një vështrim të shkurtër historik e kronologjik të legjislativës të procesit të njohjes. Kthimit dhe kompensimit të pronës në Shqipëri për të plotësuar fizionominë e këtyre organeve që e kanë administruar këtë proces ndër vite, evidentohet:*

11. Pas vitit 1991, me vendosjen e sistemit demokratik, ndodhën transformime të mëdha në të gjitha fushat. Këto transformime prekën edhe çështjen e pronave që përbën një nga themelet e shtetit të së

<sup>3</sup> Vendimi nr. 2002-12-01, datë 25.3.2003 i Gjykatës Kushtetuese të Letonisë.

<sup>4</sup> Vendimi P1. US 1/98, datë 22.9.1998 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës Çeke.

<sup>5</sup> Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 26, datë 24.4.2001, Përmbledhje vendimesh, viti 2000-2001, faqe 194.

drejtës. Shteti mori përsipër detyrimin për kthimin apo kompensimin e pronave ndaj të gjithë subjekteve të shpronësuar gjatë regjimit të mëparshëm. Ndër ligjet e miratuara për këtë qëllim ishte Ligji nr. 7698/1993, që përbën përpjekjen e parë për t'i dhënë zgjidhje çështjes së pronave.

12. Më tej, ligji nr. 7698/1993 pësoi ndryshime<sup>6</sup> të vazhdueshme, të cilat reflektonin dinamikën e problematikave<sup>7</sup> që shfaqeshin gjatë zbatimit të tij në praktikë. Sipas këtij ligji funksiononte Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Bashki (ish-KKKP) (për zonat urbane) dhe në rrethe (për zonat jashtë vijave kufizuese urbane) (ish-KKKP), të cilat njihnin, kthenin apo kompensojnë ish-pronarët. Nivelin e sipërm administrativ drejtohej nga Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që funksiononte si organ monokratik që drejtohej nga Kryetari. Ky komitet nuk kishte kompetenca rishikimi ndaj vendimeve të nivelit vendor administrativ.

13. Ligji nr. 9235/2004 shfuqizoi ligjin e mëparshëm 7698/1993, ligjvënësi u kujdes që trajtimi i çështjeve të pronës të udhëhiqej nga konceptet kushtetuese që kanë të bëjnë me "interesin publik" dhe "shpërblimin e drejtë", si dhe nga respektimi i parimeve të drejtësisë (ndershmërisë dhe barazisë), të proporcionalitetit<sup>8</sup> dhe të shtetit social<sup>9</sup> në përputhje me standardet demokratike të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1998 dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ndryshimet më të rëndësishme të këtij ligji konsistojnë në:

<sup>6</sup> I amenduar me ligj nr. 7736, datë 21.7.1993; ligj nr. 7765, datë 2.11.1993; ligj nr. 7808, datë 30.3.1994; ligj nr. 7879, datë 1.12.1994; ligj nr. 7916, datë 12.4.1995.

<sup>7</sup> - Paraqitja jo në kohën e duhur e kërkesave për kalimin e pronësisë pjesërisht për shkak të vështirësive në gjetjen e dokumenteve të regjistrimit të pronësisë, dokumentet e shpronësimit, shtetëzimit etj.

- Kërkohej më shumë fleksibilitet në organizimin e organeve e ngarkuara për njohjen dhe kalimin e pronësisë;

- Eksperiencë e pamjaftueshme për t'u përballur me një fenomen të tillë

- Pasaktësira në hartat për përcaktimin e vijave kufizuese etj.

<sup>8</sup> Me qëllim që një ndërhyrje ndaj së drejtës së pronës të jetë e justifikuar, është e domosdoshme që të ekzistojë edhe një marrëdhënie përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet.

<sup>9</sup> Konsideratat historike, politike, ekonomike, shoqërore e juridike....shih vendimin nr. 30, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese (Vol-30-05)

- a) Zgjerimin e mënyrave të kompensimit<sup>10</sup>;
- b) rritjen nga 60 ha në 100 ha të kufirit maksimal të lejuar për sipërfaqen e tokës bujqësore që i njihet një subjekti të shpronësuar dhe njohjen e kthimit e pakufizuar të llojeve të tjera të tokave si troje, pyje, kullota, etj;
- c) Parashikimin e mundësisë për të shpronësuarit që t'u njihen dhe kthehen pronat që nuk i shërbejnë më një interesi publik;
- d) Parashikimin e detyrimit për krijimin e fondit të pronave të paluajtshme që do të shërbejnë për kompensim fizik dhe të fondit për kompensim financiar;
- e) Parashikimin e mundësisë për kompensim fizik në natyrë të të shpronësuarve me pasuri të paluajtshme publike në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit.

14. Me ligjin nr. 9235/2004 u krijua Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, që ishte në varësi të Kuvendit të Shqipërisë dhe i organizuar në komisione vendore në secilin qark të vendit. Pra, sistemi i vendimmarrjes vazhdonte të ishte i decentralizuar dhe i drejtuar në nivelin e sipërm nga një organ kolegjal prej pesë anëtarësh, të cilët zgjidheshin nga Kuvendi. *Në dallim nga ligji i mëparshëm nr. 7698, Komiteti (si organ kolegjal), sipas ligjit nr. 9235 kishte kompetenca rishikimi ndaj vendimeve të dhëna në nivel vendor.*

15. Me ndryshimet e mëtejshme të ligjit nr. 9235 në vitin 2006, Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronës u shkri dhe u krijua Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (*më tej referuar si "AKKP"*) dhe zyrat e saj rajonale në qarqe që ishin në varësi të pushtetit ekzekutiv (*Ministrisë së Drejtësisë*) duke pasur një organizim të centralizuar. *Në ndryshim nga Komiteti që ishte organ kolegjal, AKKP-ja është organ monokratik që drejtohet nga drejtori i përgjithshëm<sup>11</sup>, i cili do të bënte rishikimin e*

<sup>10</sup> Me miratimin e Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 u zgjeruan format e kompensimit të pronës. Neni 11 i këtij ligji parashikoi gjashtë forma kompensimi nga pesë që ishin më parë:

- 1. Me pronë tjetër të paluajtshme të të njëjtit lloj, me vlerë të barabartë në pronësi të shtetit;
- 2. Me pasuri të paluajtshme publike në zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit;
- 3. Me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit;
- 4. Me aksione në shoqëri me kapital shtetëror;
- 5. Me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit;
- 6. Me të holla.

<sup>11</sup> Sipas formës dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të miratuar me VKM nr. 566, datë 9404

*vendimeve të dhëna nga zyrat rajonale.* Ligji<sup>12</sup> përcaktoi se afati i pranimit të kërkesave për njohje të pronës do të përfundonte në datën 30.9.2007, ndërsa afati përfundimtar për shqyrtimin e tyre do të ishte data 30.6.2008. Ndryshimet e mëvonshme të ligjit<sup>13</sup> shtynë afatet e mësipërme për pranimin e kërkesave të reja duke parashikuar si afat përfundimtar datën 31.12.2008, ndërsa për shqyrtimin e tyre si afat përfundimtar datën 30.6.2009.

16. Gjithsesi, nëse ish-pronari apo subjekti i shpronësuar (terma këta të përdorur nga ligji në kohë të ndryshme për sa u përket subjekteve) ka humbur afatin për paraqitjen e kërkesave të reja, për shkaqe të arsyeshme, mund ta rivendosë atë duke paraqitur kërkesë në gjykatë.

17. Ndërkohë me ndryshimet e kryera me ligjin 10207/2010<sup>14</sup> u suprimuan zyrat rajonale të AKKP-së në qarqe dhe i gjithë procesi administrativ i shqyrtimit dhe vendimmarrjes është përqendruar pranë një organi të vetëm administrativ që është AKKP-ja. Qëllimi i kësaj nisme është kryerja e procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes administrative në një nivel të vetëm administrativ nga dy nivele që ishte më parë. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet:

- a) një proces administrativ më i shpejtë dhe më efikas;
- b) përpunimi dhe shqyrtimi i praktikave sipas një metodike uniforme;
- c) konsolidimi i sigurisë juridike (*duke qenë i njëjti organ në shkallë vendi që trajton të gjitha aplikimet për njohje, kthim e kompensim dhe ka dijeni të hollësishme për të gjithë ecurinë e procesit në të gjithë vendin*);
- d) rritja e përgjegjshmërisë për përmbylljen e procesit;
- e) garantimi i një procesi të rregullt administrativ në përputhje me parimet themelore të ligjshmërisë, drejtësisë, paanësisë dhe deburokratizimit, rritja e transparencës gjatë vendimmarrjes dhe shkurtrim i afateve për realizimin e kësaj vendimmarrje.

18. Me ligjin nr. 55/2012 kemi një shtyrje tjetër të afatit përfundimtar të pranimit të kërkesave të reja për njohjen e së drejtës së kthimit apo kompensimin të pronës duke u përcaktuar data 30.4.2014. Përfundimi i procesit të shqyrtimit dhe vendimmarrjes u shty deri në fund të prillit të 2014-ës, me qëllim përfundimin e

23.8.2006 "Për organizimin dhe funksionimin e AKKP-së".

<sup>12</sup> Ligji nr. 9388, datë 4.5.2005 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004"

<sup>13</sup> Ligji nr. 9898, datë 10.4.2008

<sup>14</sup> Ligji nr. 10207, datë 23.12.2009 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës"

shqyrtimit të aplikimeve ende të pashqyrtuara për kthim dhe kompensim, si dhe të ankimeve administrative.

19. Në analizë të sa më sipër, pavarësisht se qëllimi i hartimit dhe miratimit të legjislacionit për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave ka qenë rivendosja në vend e së drejtës së pronësisë për pronat që iu janë marrë padrejtësisht nga shteti ish-pronarëve, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë së krijuar mbi këtë të drejtë, në thelb, përmes këtij legjislacioni, është krijuar një gjendje ose status i ri i të drejtave të pronësisë në Shqipëri, në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila në lidhje me mënyrën e krijimit të pronës private i referohet ligjeve specifike. *(Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. (Neni 41/2), e më tej, në vështrim të nenit 163 të Kodit Civil, përcaktohet se pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë).*

20. Vlerësimi i mësipërm gjen qasje me vendimin nr. 6/2013 të Gjykatës Kushtetuese, ku ndër të tjera kjo gjykatë arsyeton se: *“natyra e ligjeve që parashikojnë njohjen, rikthimin dhe kompensimin e pronës të konfiskuar nën regjimin e mëparshëm komunist, në vetvete gjeneron një të drejtë të re pronësie në favor të personave që përmbushin kushtet e titullarit të së drejtës, e drejtë kjo që mbrohet nga neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që parashikon se: “çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Askush nuk privohet nga pronat e tij përveçse në rastet e interesit publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara në ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.*

21. Në vijim të kësaj logjike juridike, si dhe në interpretim të kuadrit ligjor të sipërcituar që ka të bëjë vetëm me kthimin dhe kompensimin, si dy rregullime ligjore të së drejtës të subjekteve të shpronësuara, arrihet në përfundimin se këto të drejta (kthimi dhe/ose kompensimi) janë të drejta subjektive, jo absolute. Pasi këto të drejta fitohen vetëm pasi plotësohen kushtet dhe kriteret që lejon norma ligjore (e drejta materiale). Ligji ka parashikuar që çasti i fitimit të tyre këtyre të drejtave (kthimi dhe/ose kompensimi) lidhet me shprehjen e vullnetit të organit publik (ish-KKKP/AKKP), i cili pasi kryen një hetim të plotë administrativ verifikon plotësimin e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj për subjektet përfitues që pretendojnë këtë të drejtë, disponon me vendim, i cili përmban të gjithë tiparet e një akti administrativ, pasi referuar legjislacionit të kohës i është nënshtruar si kontrollit të brendshëm administrativ dhe atij të jashtëm gjyqësor.

22. Pra, pavarësisht se e drejta subjektive që disponohet përmes vendimit të ish-KKKP/AKKP ka karakter civil, nga pikëpamja formale ato mbeten akte individuale me karakter administrativ, të nxjerra nga një organ publik gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative sipas funksionit publik të përcaktuar nga ligji dhe që krijojnë pasoja juridike mbi të drejta subjektive të subjektit të shpronësuar.

23. Përcaktimi i natyrës së vendimit/aktit, nga pikëpamje formale, dikton dhe gjykatën që duhet të ushtrojë kontrollin gjyqësor së tij, e cila në rastin konkret duhet të jetë Gjykata Administrative.

24. Lidhur me qëndrimin e Gjykatës së Kushtetuese së mbajtur në vendimin nr. 27, datë 26.10.2010 se: *“... Kërkesa e një personi para organeve të kthimit dhe kompensimit të pronave ... është një e drejtë subjektive dhe jo një interes i ligjshëm i tij, në kuptim të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo do të thotë, nga ana tjetër, se vendimet e KKKP-së dispononin drejtpërsëdrejti mbi të drejta subjektive, të cilat janë ekskluzive të titullarëve të caktuar dhe jo të shtetasve apo publikut në tërësi, siç janë interesat publikë. Ky fakt mund të konstatohet nga gjykata pasi e drejta e një personi për t’u njohur si pronar i një sendi rregullohet nga Kodi Civil, si rrjedhim gjykata çmon se jemi jashtë fushës së veprimit të së drejtës publike e cila rregullon veprimet e organeve shtetërore në mbrojtje të interesave publikë. ...vendimet e organeve administrative, që kanë pasur si kompetencë kthimin dhe kompensimin e pronave, në vite, nuk mund të konsiderohen akte administrative, në kuptimin normal juridik të termi (strictu sensu), por akte “sui generis” të nxjerra nga një organ “sui generis”, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë. ....Në këto kushte, kur një person vinte në lëvizje me kërkesë KKKP, kjo kërkesë ishte e barazvlefshme si të ishte bërë para gjykatës dhe vendimi i KKKP-së ishte në gjendje që të krijonte tek individit të njëjtën pritshmëri që krijon një vendim gjyqësor i cili i njeh individit pronësinë mbi një send. Në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen “Viasu kundër Rumanisë”, “Ramadhi, apo Hamzaraj, kundër Shqipërisë”, duke barazuar vendimin e KKKP-së me një vendim gjyqësor i cili krijon pritshmërinë e ligjshme tek individit se ose do të vihet në posedim të pronës, ose do të dëmshpërblehet...”. Qëndrim ku mbështetet vendimi i shumicës së gjyqtarëve, pakica është e mendimit se vlerësimi i bërë nga Gjykata Kushtetuese, në këtë çështje, lidhet me pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike për aktet (vendimet) e nxjerra nga organe publike (ish-KKKP) të cilat për nga tiparet që kanë lidhur me mënyrën e emërimit të anëtarëve, mandatit të tyre, ushtrimit të*

garancive ndaj presioneve të jashtme dhe çështjes nëse organi ka nivelin e duhur të pavarësisë, janë cilësuar si *quasi* gjyqësor.<sup>15</sup> Në këtë kontekst, këto akte nuk mund t'i nënshtroheshin kontrollit të një organ tjetër publik monokratik siç ishte drejtori i AKKP-së, në vështrim të ndryshimeve të bëra në ligjin 9235/2004.

25. Prandaj, Gjykata Kushtetuese ka çmuar gjykatën e zakonshme civile si një gjykatë kompetente për rishikimin e këtyre akteve të cilësuar *sui generis*, si garanci të kontrollit gjyqësor mbi aktet administrative që disponojnë të drejta subjektive. Duhet pasur parasysh se ky qëndrim i Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me periudhën kur nuk ishin krijuar ende Gjykatat Administrative dhe nuk kishin lindur probleme të kompetencës lëndore midis gjykatave civile dhe atyre administrative.

26. Në kushtet kur janë krijuar Gjykata Administrative, si gjykata të specializuara për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, referuar nenit 7, pikat "a" dhe "b" të ligjit nr. 49/2012 ku përcaktohet se në kompetencën lëndore të kësaj gjykate, ndër të tjera, përfshihen *mosmarrëveshje që lindin për aktet administrative individuale, akte nënligjore normative dhe kontratat administrative publike të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative të organe publike; si mosmarrëveshjet që lindin për shkak të ndërhyrjes së paligjshme ose të mosveprimet të organit publik.*

27. Parë nën dritën e këtij rregullimi ligjor, kundërshtimi i vendimit të KKKP/AKKP për nga natyra e mosmarrëveshjes që krijohet, i përmbush kriteret për t'u gjykuar nga gjykata administrative, pasi:

a) *Së pari*, ish-KKKP/AKKP në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 janë organe publike dhe ushtrojnë veprimtari administrative të parashikuara nga ligji i posaçëm.

b) *Së dyti*, vendimet e nxjerra prej tyre, në kuptim të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 janë akte administrative individuale, pasi shprehin vullnetin e organit publik në ushtrimin e funksionit të tij publik ndaj një subjekti individualisht të përcaktuar të së drejtës duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete, që në rastin konkret i përkasin të drejtave të pronësisë (kthim dhe/ose kompensim) në favor të subjektit të shpronësuar.

28. Ky qëndrim është në koherencë të plotë dhe me përkufizimet e dhëna në nenin 2 të ligjit nr. 49/2012 lidhur me kuptimet që iu janë dhënë veprimeve/mosveprimeve administrative si shprehje e një forme të njëanshme të veprimtarisë së organit publik/apo mungesë e saj, që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshme.

29. Për rrjedhojë, pakica çmon se duhet t'i *transferohen juridiksionit administrativ*

*mosmarrëveshjet në të cilat ngrihen çështje të interesave të ligjshme dhe të drejtave subjektive të përcaktuara nga ligji që kanë të bëjnë me ushtrimin apo mosushtrimin e pushtetit administrativ për sa u përket akteve, marrëveshjeve apo sjelljeve/veprimeve të cilat në mënyrë të tërthortë çojnë në ushtrimin e këtij pushteti nga administrata publike".*

30. Por, edhe në vështrim të ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Civile me ligjin 49/2012<sup>16</sup>, lidhur me shfuqizimin e neneve 324-333 që për gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative, gjykata civile, nga pikëpamja e lëndës (materies), është në pamundësi të gjykojë në themel një çështje me objekt kundërshtim vendimi të AKKP/ish-KKKP, pasi këtë mundësi ia lejonin vetëm përcaktimet e bëra në nenin 331 të K.Pr.C. Këto përcaktime tashmë janë parashikuar në nenin 40 të ligjit nr. 49/2012.

31. Mbështetur sa më lart, ne gjyqtarët në pakicë, kemi mendimin se **shqyrtimi i çështjeve me objekt kundërshtim vendimin e ish-KKKP/AKKP duhet të konsiderohet si mosmarrëveshje administrative dhe të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.** Për rrjedhojë, kemi qëndrimin se vendimi nr. 1823, datë 13.11.2008 i Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilin është vendosur "*Prishja e vendimit nr. 258, datë 10.5.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Mat dhe pushimin e gjykimit të çështjes*", është rrjedhojë e mosrespektimit të ligjit dhe për këtë shkak me të drejtë *Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 4/4, datë 10.12.2013, kanë vendosur* "Prishjen e vendimit e këtij vendimi", por si gjyqtarë në pakicë, në ndryshim nga shumica, vlerësojmë se "kthimi i çështjes për rishqyrtim" duhet të bëhet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe jo në Gjykatën e Apelit Tiranë, sikurse ka vendosur shumica.

32. Në qëndrimin e saj, pakica mori në diskutim edhe situatën aktuale në Shqipëri, ku janë krijuar disa organe publike<sup>17</sup> që veprojnë mbi të drejtat e pronësisë, veprimtaria e të cilave rregullohet nga pjesë të ndryshme të legjislacionit, të cilat trajtojnë në mënyrë të fragmentarizuar dhe jokohereente çështje të pronësisë dhe të regjistrimit të titujve të pronësisë. Në këto kushte, do të ishte e domosdoshme që të analizohej në tërësi natyra dhe specifikat e gjithë akteve administrative të nxjerra nga këto organe publike që kanë krijuar titujt e pronësisë, në mënyrë që

<sup>16</sup> Neni 72 shfuqizime dhe ndryshime.

<sup>17</sup> Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të Pronës për subjektet e shpronësuar, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Informale për legalizimin e ndërtimeve informale, Komisioni Qeveritar i Tokës për vlefshmërinë e titujve të pronësisë dhe Enti Kombëtar i Banësve për banesat sociale.

të shmangët paqartësia dhe pasiguria e palëve (subjekte përfitues) në lidhje me kontrollin gjyqësor të këtyre akteve.

33. Por, gjithsesi, nuk mund të anashkalohen në këtë qëndrim edhe problematikat e mosmarrëveshjeve që mund lindin nga veprimet dhe/ose aktet e AKKP-së, të cilat duhen parë rast pas rasti, në funksion të zgjidhjes së kompetencës lëndore.

Tiranë, më, 10.12.2013

Anëtarë: Ardian Nuni, Arjana Fullani, Ardian Dvorani, Aleksandër Muskaj, Artan Zeneli, Evelina Qirjako

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2014, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Çmimi 32 lekë

Adresa: bulevardi "Gjergj Fishta", pas ish-ekspozitës "Shqipëria Sot",  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006